LIGJ
Nr.9370, datë 14.4.2005

PËR RATIFIKIMIN E INSTRUMENTEVE, QË NDRYSHOJNË KUSHTETUTËN DHE KONVENTËN E BASHKIMIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT (GJENEVË, 1992)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet instrumenti, që ndryshon Kushtetutën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë, 1992).

Neni 2

Ratifikohet instrumenti, që ndryshon Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë, 1992).

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4548, datë 29.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

KONVENTA

KAPITULLI I
FUNKSIONIMI I UNIONIT

SEKSIONI 1
Neni 1
Konferenca e të plotfuqishmëve

Ndryshuar 2-1998 2) Nëse është e mundur, vendi i saktë dhe datat ekzakte të konferencës së të plotfuqishmëve do të përcaktohen në konferencën e mëparshme e të plotfuqishmëve; në rast të kundërt, ato do të fiksohen nga Këshilli në bashkëpunim me maxhorancën e shteteve anëtare.

Ndryshuar 4-1998 a) kur të paktën një e katërta e shteteve anëtare i kanë propozuar individualisht Sekretarit të Përgjithshëm një ndryshim.

Ndryshuar 6-1998 2) Ndonjë ndryshim i tillë do të kërkojë aprovim të maxhorancës së shteteve anëtare.

Neni 2
Zgjedhjet dhe çështje që lidhen me to

Këshilli

Ndryshuar 7-1998 1) Përveç rasteve të vendeve të lira, të krijuara në rrethanat e përshkruara në nr.10 deri 12 më sipër, shtetet anëtare të zgjedhura në Këshill do të ushtrojnë funksionet e tyre deri në datën në të cilën zgjidhet një Këshill i ri. Ata do të kenë të drejtën të rizgjidhen.

Ndryshuar 8-1998 2. 1) Nëse krijohet një vend i lirë në Këshill, përmes dy konferencave të të plotfuqishmëve, ai do t'i kalojë, si e drejtë, shtetit anëtar, që ndodhet në të njëjtin rajon me shtetin anëtar që la vendin e lirë, i cili ka fituar në zgjedhjet e mëparshme numrin më të madh të votave ndërmjet atyre që nuk janë zgjedhur.

Ndryshuar 9-1998 2) Kur për ndonjë arsye një vend i lirë nuk mund të zëvendësohet, në përputhje me procedurat e nr.8 më sipër, kryetari i Këshillit do të ftojë shtetet anëtare të tjera të rajonit të kërkojnë zgjedhje brenda një muaji nga dërgimi i ftesave. Në përfundim të kësaj periudhe, kryetari i Këshillit do të ftojë shtetet anëtare të zgjedhin një shtet anëtar të ri në Këshill. Zgjedhjet do të kryen me votim të fshehtë në korrespondencë. E njëjta maxhorancë e përmendur më sipër do të kërkohet. Shteti anëtar i ri do të ushtrojë funksionet e tij deri në zgjedhjen e një Këshilli të ri nga konferenca tjetër kompetente e të plotfuqishmëve.

(Ndryshuar)11-2002 a) kur një shtet anëtar i Këshillit nuk ka pasur përfaqësues prezent në dy seksione të njëpasnjëshme të Këshillit;

Ndryshuar 12-1998 b) kur një shtet anëtar jep dorëheqjen për anëtarësimin e tij në Këshill.

Anëtarët e Bordit të Rregulloreve Radio

(Ndryshuar) 21-2002 2. Në qoftë se në intervalin ndërmjet dy konferencave të të plotfuqishmëve një anëtar i Bordit jep dorëheqjen ose nuk është në gjendje të kryejë detyrat e tij, Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me drejtorin e Byrosë së Radiokomunikacionit, do të ftojë shtetet anëtare të rajonit përkatës të propozojnë kandidatët për zgjedhjen e zëvendësuesit në sesionin e ardhshëm të Këshillit. Megjithatë, nëse vendi i lirë krijohet 90 ditë më parë se një sesion i Këshillit ose pas sesionit të Këshillit që paraprin konferencën e ardhshme të të plotfuqishmëve, shtetet anëtare të rajonit duhet të caktojnë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda 90 ditëve, një zëvendësues me kombësi tjetër, i cili do të kryejë funksionet deri sa anëtari i ri i zgjedhur nga Këshilli të marrë detyrën ose, nëse duhet, deri sa anëtarët e rinj të Bordit të zgjidhen nga konferenca e ardhshme e të plotfuqishmëve. Nëse është e nevojshme, procesi zgjedhur do të pranohet për votë nga Këshilli ose nga konferenca e të plotfuqishmëve.

Ndryshuar 22-2002 3. Një anëtar i Bordit të Rregulloreve Radio konsiderohet si i papërshtatshëm për të kryer detyrat e tij pas tri mungesave të njëpasnjëshme në mbledhjet e Bordit. Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimit me kryetarin e Bordit dhe anëtarin e Bordit, si dhe shtetin anëtar përkatës, deklarojnë ekzistencën e një vendi të lirë në Bord dhe do të veprohet siç u tregua në nr.21 më sipër.

Neni 3

Ndryshuar **Konferencat dhe asambletë e tjera**

Ndryshuar 23-1998 1. Në pajtim me dispozitat përkatëse të kësaj Kushtetute, midis dy konferencave të të plotfuqishmëve organizohen normalisht konferencat dhe asambletë e mëposhtme botërore të Unionit:

Ndryshuar 24-1998 a) një ose dy konferenca botërore të radiokomunikacionit;

Ndryshuar 25-1998 b) një asamble botërore e standardizimit të telekomunikacionit;

Ndryshuar 27-1998 d) një ose dy asamble të radiokomunikacionit;

Hequr 29-1998

Ndryshuar 30-1998-mund të organizohet dhe një asamble shtesë e standardizimit të telekomunikacionit;

Ndryshuar 33-1998 b) me rekomandim të konferencës ose asamblesë së mëparshme botërore të sektorit përkatës, nëse është aprovuar nga Këshilli; në rastin e asamblesë së radiokomunikacionit, rekomandimi i asamblesë do t'i transmetohet konferencës pasardhëse botërore të radiokomunikacionit për komentet në vëmendje të Këshillit;

Ndryshuar 34-1998 c) me kërkesën e të paktës një të katërtës të shteteve anëtare, të cilat do t'i adresojnë, individualisht, kërkesat e tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm; ose

Ndryshuar 39-1998 c) me kërkesën e të paktës një të katërtës të shteteve anëtare që i përkasin rajonit në fjalë, të cilat do t'i adresojnë individualisht kërkesat e tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm; ose

Ndryshuar 41-1998 5. 1) Vendi preciz dhe datat e sakta për një konferencë ose asamble të një

sektori mund të fiksohen nga një konferencë e të plotfuqishmëve.

Ndryshuar 42-1998 2) Në mungesë të një vendimi të tillë, Këshilli do të përcaktojë, në konsensus me maxhorancën e shteteve anëtare, vendin dhe datat e sakta për një konferencë ose asamble të një sektori, dhe me konsensus të maxhorancës së shteteve anëtare që i përkasin një rajoni, vendin dhe datat e sakta për zhvillimin e konferencës së rajonit përkatës; në të dyja rastet do të aplikohen dispozitat e nr.47 më sipër.

Ndryshuar 44-1998 a) me kërkesën e të paktës një të katërtës të shteteve anëtare në rastin e një konference ose asambleje botërore të një sektori, ose e të paktën një të katërtave të shteteve anëtare që i përkasin një rajoni për rastin e një konference rajonale. Kërkesat e tyre do t'i adresohen individualisht Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do t'ia transmetojë ato Këshillit për aprovim; ose

Ndryshuar 46-1998 2) Për rastet e specifikuara në nr.44 dhe 45 më sipër, ndryshimet e propozuara nuk do të kenë një aprovim final deri sa ato të pranohen nga shumica e shteteve anëtare, në rastin e një konference ose asambleje botërore të një sektori, ose nga shumica e vendeve anëtare që i përkasin rajonit, në rastin e një konference rajonale, subjekt i kërkesave të nr.47 më sipër.

Ndryshuar 47-2002 7. Në konsultimet referuar në nenet 42, 46, 118, 123 dhe 138 të kësaj konvente dhe në nenet 26, 28, 29, 31 dhe 36 të rregulloreve të përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit, shtetet anëtare që nuk janë përgjigjur brenda kohës së kufizuar të caktuar nga Këshilli do të konsiderohen si jopjesëmarrëse në konsultime, dhe si rrjedhim nuk do të merren në konsideratë në përcaktimin e maxhorancës. Në qoftë se numri i përgjigjeve të marra nuk kalon gjysmën e shteteve anëtare të konsultuara, një konsultim i mëtejshëm do të ndërmerret, rezultatet e së cilës do të vendosen në përputhje me numrin e votave.

SEKSIONI 2
Neni 4
Këshilli

Ndryshuar 50-1998 1. Numri i anëtarëve të Këshillit do të përcaktohet nga konferenca e të plotfuqishmëve, e cila do të mbahet çdo katër vjet.

Ndryshuar 50A -1998 2. Ky numër nuk do të kalojë 25% të numrit total të anëtarëve të Unionit.

Ndryshuar 53-1998 3. Midis dy sesioneve të zakonshme, Këshilli mund të mblidhet, në përgjithësi në selinë e Unionit, nga kryetari me kërkesë të maxhorancës së shteteve anëtare të saj, ose me iniciativë të kryetarit nën kushtet e përcaktura për të në nr.18 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 55-1998 4. Në fillim të çdo sesioni të zakonshëm, Këshilli do të zgjedhë, ndërmjet përfaqësuesve të shteteve anëtare, kryetarin dhe nënkryetarin e tij, duke marrë në konsideratë parimin e rotacionit midis rajoneve. Ata do ta ruajnë këtë pozicion deri në hapjen e sesionit tjetër të zakonshëm dhe nuk do të kenë të drejtën e rizgjedhjes. Në mungesë të kryetarit, funksionet e tij i kryen nënkryetari.

Ndryshuar 56-1998 5. Personi i caktuar nga një shtet anëtar i Këshilli të shërbejë në Këshill duhet të jetë, mundësisht, një zyrtar që shërben, ose është përgjegjës direkt, në administratën e telekomunikacionit dhe i kualifikuar në fushën e shërbimeve të telekomunikacionit.

Ndryshuar 57-1998 6. Uninoni do të mbulojë vetëm shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit dhe siguracionit për përfaqësuesit në sesionet e Këshillit, të çdo shteti anëtar të Këshillit, që i përkasin kategorisë së vendeve në zhvillim, lista e të cilëve është krijuar nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara.

Ndryshuar 58-1998 7. Përfaqësuesi i çdo shteti anëtar në Këshill do të ketë të drejtë të ndjekë, si vëzhgues, të gjitha mbledhjet e sektorëve të Unionit.

Ndryshuar 60-1998 9. Sekretari i Përgjithshëm, nënsekretari i përgjithshëm dhe drejtorët e byrove mund të marrin pjesë, si e drejtë e tyre, në diskutimet e Këshillit, por pa marrë pjesë në votime. Megjithatë, Këshilli mund të zhvillojë mbledhje të mbyllura me përfaqësuesit e shteteve anëtare të tij.

Ndryshuar 60A-2002 9 bis Një shtet anëtar, i cili nuk është anëtar në Këshill, pasi njofton Sekretarin e Përgjithshëm, mund të dërgojë, me shpenzimet e veta, një vëzhgues në mbledhjet e Këshillit, komitetet dhe grupet e punës së saj. Ky vëzhgues nuk do të ketë të drejtën e votës.

Shtuar 60 B-2002 9 ter Anëtarët e sektorit mund të përfaqësohen me statusin e vëzhguesit në mbledhjet e Këshillit, komitetet dhe grupet e punës së saj, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli dhe kërkesat që lidhen me numrin e këtyre vëzhguesve dhe procedurat për caktimin e tyre.

Ndryshuar 61-1998 10. Këshilli do të marrë në konsideratë, çdo vit, raportin e përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e planit strategjik të aprovuar nga konferenca e të plotfuqishmëve dhe do të kryejë veprimet e nevojshme.

Shtuar 61A-2002 10 bis Ndërsa në gjithë kohëzgjatjen respektohen kufijtë financiarë të aprovuar nga konferenca e të plotfuqishmëve, Këshilli, kur është e nevojshme, mund të rishikojë dhe përmirësojë planin strategjik, i cili përbën bazat e planeve operacionale përkatëse dhe informon për këtë shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit.

Shtuar 61B-2002* 10 ter Këshilli do të aprovojë rregullat procedurale të saj.

Shtuar 62A -2002 1) do të marrë dhe rishikojë të dhënat specifike për planin strategjik të siguruar nga Sekretari i Përgjithshëm siç u përshkrua në nr.74A të Kushtetutës dhe, në sesionin e fundit të zakonshëm të Këshillit para konferencës së ardhshme të të plotfuqishmëve, fillon përgatitja e draftit të planit të ri strategjik për Union, duke mbledhur informacionet nga shtetet anëtare, anëtarët e sektorit dhe nga grupet këshilluese të sektorëve, dhe harton një draft plani të ri strategjik të paktën katër muaj para konferencës së të plotfuqishmëve;

Shtuar 62B-2002 1 bis) do të krijojë një kalendar për zhvillimin e planeve strategjike dhe financiare për Unionin dhe planeve operacionale për çdo sektor dhe për Sekretariatin e Përgjithshëm, për të lejuar në këtë mënyrë ecurinë e përshtatshme dhe bashkëpunim të këtyre planeve;

Ndryshuar 69-1998 3) do të marrë vendime për të siguruar shpërndarjen e barabartë gjeografike dhe përfaqësimin e grave në kategoritë profesionale dhe më të larta të stafit të Unionit dhe do të monitorojë zbatimin e tyre;

Ndryshuar 73-2002 7) do të rishikojë dhe aprovojë buxhetin dyvjeçar të Unionit, dhe do të diskutojë mbi parashikimin e buxhetit (të përfshirë në raportin operacional financiar përgatitur nga Sekretari i Përgjithashëm sipas nr.101 të kësaj konvente) për periudhën dyvjeçare në vazhdim të periudhës me buxhet të aprovuar, duke marrë parasysh vendimet e konferencës së të plotfuqishmëve lidhur me nr.50 të Kushtetutës dhe kufijtë financiarë të vendosur nga konferenca e të plotfuqishmëve, në përputhje me nr.51 të Kushtetutës; do të sigurojë një ekonomi, mundësisht më strikten, por dhe të kujdesshme të detyrimeve të Unionit për të arritur, sa më shpejt të jetë e mundur, rezultate të kënaqshme. Në këtë rast, Këshilli do të marrë në konsideratë prioritetet e përcaktuara nga konferencat e të plotfuqishmëve, siç është shprehur në planin strategjik për Unionin, pikëpamjet e Komitetit Koordinativ, siç i kërkon raporti i Sekretarit të Përgjithshëm, përmendur në nr.86 të kësaj konvente, dhe raporti operacional financiar, përmendur në nr.101 të kësaj konvente;

Ndryshuar 75-1998 9) do të organizojë zhvillimin e konferencave dhe asambleve të Unionit dhe, me miratimin e maxhorancës së shteteve anëtare në rastin e konferencave apo asambleve botërore, ose me aprovimin e maxhorancës së shteteve anëtare të rajonit përkatës në rastin e konferencave rajonale, siguron direktiva të përshtatshme për Sekretariatin e Përgjithshëm dhe sektorët e Unionit lidhur me asistencën teknike të tyre dhe asistenca të tjera në përgatitjen dhe organizimin e konferencave dhe asambleve;

Ndryshuar 79-2002 13) do të ndërmarrë hapat e nevojshme, në marrëveshje me maxhorancën e shteteve anëtare, për të zgjidhur çështje që nuk mbulohen nga Kushtetuta, nga kjo konventë dhe rregulloret administrative, të cilat nuk mund të presin konferencën kompetente për zgjidhje;

Ndryshuar 80-2002 14) do të jetë përgjegjës për të bërë efektiv koordinimin me të gjitha organizatat ndërkombëtare referuar në nenet 49 dhe 50 të Kushtetutës dhe në përfundim të konkludojë, në emër të Unionit, marrëveshjet e përkohshme me organizatat ndërkombëtare, referuar në nenin 50 të Kushtetutës dhe në nr.260 dhe 261 të konventës, dhe me Kombet e Bashkuara në zbatim të marrëveshjeve ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit; këto marrëveshje të përkohshme do t'i paraqiten konferencës së të plotfuqishmëve, në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit 8 të Kushtetutës;

Ndryshuar 81-2002 15) do t'u dërgojë shteteve anëtare, brenda 30 ditëve pas çdo sesioni të saj, dokumentet përmbledhëse të aktiviteteve të Këshillit dhe dokumente të tjera që gjykohen të nevojshme.

SEKSIONI 3

Neni 5

Sekretariati i Përgjithshëm

Ndryshuar 86-1998 c) do të përgatisë me ndihmën e Komitetit Koordinativ dhe do të paraqesë në Këshill një raport që tregon ndryshimet në fushën e telekomunikacionit që nga konferenca e fundit e të plotfuqishmëve dhe që përmban veprime rekomanduese që lidhen me politikat dhe strategjinë e ardhme të Unionit, duke përfshirë dhe komponentët financiarë;

Shtuar 86A -1998 c bis) do të koordinojë zbatimin e planit strategjik të aprovuar nga konferenca e të plotfuqishmëve dhe do të përgatisë një raport vjetor të këtij zbatimi për t'u rishikuar nga Këshilli;

Ndryshuar 87A-2002 d bis) do të përgatisë çdo vit, në përputhje me planin strategjik, një plan operacional katërvjeçar, që mbulon vitin pasardhës dhe periudhën trevjeçare në vazhdim, për aktivitetet që

do të ndërmerren nga stafi i Sekretariatit të Përgjithshëm, duke përfshirë termat financiarë dhe duke marrë në konsideratë planin financiar të aprovuar nga konferenca e të plotfuqishmëve; ky plan katërvjeçar operacional do të rishikohet nga grupet këshilluese të të tre sektorëve dhe do të rishikohet dhe aprovohet çdo vit nga Këshilli;

Ndryshuar 100-1998 q) pas konsultimeve me Komitetin Koordinativ dhe gjetjes së mundësive ekonomike, do të përgatisë dhe paraqesë në Këshill një draftbuxhet dyvjeçar që mbulon shpenzimet e Unionit, duke marrë në konsideratë kufijtë financiarë të vendosur nga konferenca e të plotfuqishmëve. Ky draft do të përmbajë një buxhet të konsoliduar, që përfshin buxhetet e bazuara në kosto të tre sektorëve, përgatitur në përputhje me udhëzimet për buxhetin botuar nga Sekretari i Përgjithshëm, dhe do të paraqesë dy versione. Njëri version do të jetë për një rritje nga zero të njësisë së kontributit, kurse versioni tjetër për një rritje më të vogël ose të barabartë nga ndonjë kufi i vendosur nga konferenca e të plotfuqishmëve, pas ndonjë tërheqje në llogarinë rezervë. Rezoluta e buxhetit, pas miratimit nga Këshilli, do t'u dërgohet për informacion të gjitha shteteve anëtare;

Ndryshuar 102-1998 s) me ndihmën e Komitetit Koordinativ, do të përgatisë një raport vjetor për aktivitetet e Unionit, të cilat, pas miratimit nga Këshilli, do t'u dërgohen të gjitha shteteve anëtare;

Shtuar 102A-1998 s bis) do të menaxhojë marrëveshjet specifike, referuar në nr.76A të Kushtetutës, koston e këtij menaxhimi që mbulohet nga nënshkruesit e marrëveshjeve, në mënyrën e aprovuar nga ata dhe nga Sekretari i Përgjithshëm;

SEKSIONI 4
Neni 6
Komiteti Koordinativ

Ndryshuar 109-1998 2. Komiteti do të përpiqet të arrijë konkluzione unanime. Në mungesë të mbështetjes nga maxhoranca në Komitetet, kryetari i saj në rrethana të veçanta mund të marrë vendime, nën përgjegjësinë e vet, kur gjykon që vendimi merret për një çështje urgjente dhe nuk mund të pritet deri në sesionin tjetër të Këshillit. Në rrethana të tilla kryetari do të raportojë menjëherë me shkrim, për këto çështje, shtetet anëtare të Këshillit, duke dhënë sqarime për arsyet e këtij vendimi dhe komente të tjera të dhëna me shkrim nga anëtarët e tjerë të Komitetit. Nëse në të tilla rrethana çështjet nuk janë urgjente, por megjithatë të rëndësishme, ato do të paraqiten për mendim në sesionin tjetër të Këshillit.

(Ndryshuar) 111-2002 4. Do të paraqitet një raport mbi mënyrat e operimit të Komitetit Koordinativ, i cili do të mundësohet me kërkesë të shteteve anëtare të Këshillit.

SEKSIONI 5
SEKTORI I RADIOKOMUNIKACIONIT

Neni 7
Konferenca botërore e radiokomunikacionit

Ndryshuar 117-1998 d) identifikimin e çështjeve që duhen studiuar nga asambleja e radiokomunikacionit dhe grupet e studimit të radiokomunikacionit, gjithashtu çështjet që asambleja do të marrë në konsideratë për konferencat e ardhme të radiokomunikacionit;

Ndryshuar 118-1998 2) Qëllimi i përgjithshëm i kësaj axhende do të përcaktohet katër vjet përpara, dhe axhenda finale do të përcaktohet nga Këshilli, preferohet dy vjet para konferencës, me aprovim të maxhorancës së anëtarëve të Unionit, subjekt i kërkesave të nr.47 të kësaj konvente. Këto dy versione të axhendës do të krijohen në bazë të rekomandimeve të konferencës botërore të radiokomunikacionit, në përputhje me nr.126 të kësaj konvente.

Ndryshuar 121-1998 a) me kërkesën e të paktës një të katërtën e shteteve anëtare. Kërkesa të tilla do t'i adresohen individualisht Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do t'ia transmetojë ato për aprovim Këshillit; ose

Ndryshuar 123-1998 2) Ndryshimet e propozuara të axhendës së konferencës botërore të radiokomunikacionit nuk do të aprovohen në mënyrë përfundimtare, derisa të pranohen nga shumica e shteteve anëtare, subjekt i kërkesave të nr.47 të kësaj konvente.

Neni 8
Asambleja e radiokomunikacionit

Shtuar 129A-2002 1bis Asambleja e radiokomunikacionit është e autorizuar të miratojë metodat e punës dhe procedurat për menaxhimin e aktiviteteve të sektorit, në përputhje me nr.145A të Kushtetutës.

Ndryshuar 131-1998 1) të marrë në konsideratë raportet e grupeve të studimit, përgatitur në përputhje me nr.157 të kësaj konvente, do të aprovojë, modifikojë ose kundërshtojë draftrekomandimet që përmbajnë këto raporte, dhe do të marrë në konsideratë raportet e grupit këshillues të radiokomunikacionit përgatitur në përputhje me nr.160H të kësaj konvente;

Ndryshuar 136-1998 6) të raportojë në konferencën e ardhme botërore të radiokomunikacionit progresin e çështjeve që mund të jenë të përfshira në axhendën e konferencave të ardhme të radiokomunikacionit;

Shtuar 136A-2002 7) të vendosë në rast nevoje të mirëmbajë, përfundojë ose krijojë grupe të tjera dhe të caktojë kryetarin dhe nënkryetarin e tyre;

Shtuar 136B-2002 8) të krijojë termat e referencës për grupet që përmenden në nr.136A më sipër; të tilla grupe nuk do të miratojnë çështje ose rekomadime;

Ndryshuar 137A-2002 4. Një asamble radiokomunikacioni mund të caktojë çështjet specifike brenda kompetencave të saj, përveç atyre që lidhen me procedurat që përmbajnë rregulloret radio, për grupin këshillues të radiokomunikacionit duke treguar veprimin që kërkojnë këto çështje.

Neni 9

Konferencat rajonale të radiokomunikacionit

Ndryshuar 138-1998 Axhenda e një konference rajonale të radiokomunikacionit mund të përmbajë vetëm çështje specifike të radiokomunikacionit të një natyre rajonale, duke përfshirë instruksionet e Bordit të Rregulloreve Radio dhe Byrosë së Radiokomunikacionit lidhur me aktivitetet e tyre në rajonin përkatës, nëse të tilla instruksione nuk shkaktojnë konflikt me interesat e rajoneve të tjera. Në një konferencë të tillë mund të diskutohen vetëm çështjet e përfshira në axhendën e saj. Në një konferencë rajonale të radiokomunikacionit do të aplikohen dispozitat që përmbajnë nr.118 deri në 123 të kësaj konvente, por vetëm në lidhje me shtetet anëtare të rajonit përkatës.

Hequr 139 -1998

Neni 10

Bordi i Rregullores Radio

Ndryshuar 140-2002 2. Në shtesë të detyrave të specifikuara në nr.14 të Kushtetutës, Bordi:

1) do të marrë në konsideratë raportet nga drejtori i Byrosë së Radiokomunikacionit mbi investigimin e interferencave të dëmshme, të cilat kryen me kërkesën e një ose më shumë administratave të interesuara dhe do të formulojë rekomandime në lidhje me to;

2) do të marrë në konsideratë, gjithashtu dhe pavarësisht nga Byroja e Radiokomunikacionit, me kërkesë të një ose më shumë administratave të interesuara, dispozitat kundrejt vendimeve të nxjerra nga Byroja e Radiokomunikacionit lidhur me frekuencat e dhëna për përdorim.

Ndryshuar 141-2002 3. Anëtarët e Bordit do të marrin pjesë në një kapacitet këshillues, në konferencat e radiokomunikacionit. Në këtë rast, ata nuk do të marrin pjesë në këto konferenca si anëtarë të delegacioneve të vendeve të tyre.

Shtuar 141A-2002 3 bis) Dy anëtarë të Bordit, të caktuar nga Bordi, do të marrin pjesë, në një kapacitet këshillues, në konferencat e të plotfuqishmëve dhe asambletë e radiokomunikacionit. Në këto raste, dy anëtarët e caktuar nga Bordi nuk do të marrin pjesë në këto konferenca apo asamble si anëtarë të delegacioneve të vendeve të tyre.

Shtuar 142A-2002 4 bis) Anëtarët e Bordit, në kohën e ushtrimit të detyrave të tyre në funksion të Unionit, siç specifikohet në Kushtetutë dhe konventë, ose përgjatë misionit të tyre në Union, do të gëzojnë privilegjet funksionale dhe imunitetet ekuivalente me ato të dhëna te zyrtarët e zgjedhur të Unionit nga çdo shtet anëtar, në zbatim të dispozitave përkatëse të legjislacionit kombëtar ose legjislacioneve të tjera të aplikueshme në çdo shtet anëtar. Të tilla privilegje dhe imunitete funksionale u jepen anëtarëve të Bordit për qëllimet e Unionit dhe jo për avantazhe të tyre personale. Unioni mund dhe i heq imunitetin e dhënë një anëtari të Bordit sa herë që e konsideron se një imunitet i tillë është në kundërshtim me atë që kërkon drejtësia dhe nëse heqja e tij nuk dëmton interesat e Unionit.

Ndryshuar 145-2002 2) Këshilli do të mbajë normalisht mbi katër mbledhje në vit, në një

kohëzgjatje me shumë se katër ditë, në përgjithësi në selinë e Unionit, në të cilat duhet të jenë prezent të paktën dy të tretat e anëtarëve të tij dhe duhet të zbatojnë detyrat e tij duke përdorur mënyrat moderne të komunikimit. Megjithatë, në qoftë se Bordi e gjykon të arsyeshme, në varësi të çështjeve që do të shqyrtohen, mund të rrisë numrin e mbledhjeve. Në raste të jashtëzakonshme, mbledhjet mund të zgjasin deri në dy javë.

Neni 11
Grupet e studimit të radiokomunikacionit

Ndryshuar 149-1998 2. 1) Grupet e studimit të radiokomunikacionit do të studiojnë çështjet, që janë aprovuar në përputhje me procedurën e krijuar nga asambleja e radiokomunikacionit dhe do të përgatisin draftrekomandimet, të cilat do të aprovohen në përputhje me procedurat e parashtruara në nr.246A deri në 247 të kësaj konvente.

Shtuar 149B-1998 2) Grupet e studimit të radiokomunikacionit do të studiojnë, gjithashtu, çështje të identifikuara në rezolutat dhe rekomandimet e konferencave botërore të radiokomunikacionit. Rezultatet e studimeve të tilla do të përfshihen në rekomandimet ose raportet e përgatitura në përputhje me nr.156 më sipër.

Ndryshuar 150-1998 3) Studimi i çështjeve dhe temave të mësipërme, bazuar në nr.158 më sipër, do të fokusohet në:

Ndryshuar 151-1998 a) përdorimin e spektrit të radiofrekuencave nga shërbimet tokësore dhe hapësinore të radiokomunikacionit dhe orbitat e satelitëve gjeostacionarë dhe satelitëve të tjerë;

Ndryshuar 155-1998 3) Këto studime në përgjithësi nuk do t'u adresohen çështjeve ekonomike, por kur ato përfshijnë alternativa krahasuese teknike ose operacionale, mund të merren parasysh faktorët ekonomikë.

Neni 11A
PP-98 **Grupi këshillues i radiokomunikacionit**

Ndryshuar 160A-2002 1. Grupi këshillues i radiokomunikacionit do të jetë i hapur të përfaqësojë administratat e shteteve anëtare, të përfaqësojë anëtarët e sektorit dhe të kryesojë grupet e studimit dhe grupet e tjera, dhe do të veprojë nëpërmjet drejtorit;

Ndryshuar 160B-1998 2. Grupi këshillues i radiokomunikacionit:

Ndryshuar 160C-1998 1) do të rishikojë prioritetet, programet, veprimet, çështjet financiare dhe strategjike, lidhur me asambletë e radiokomunikacionit, grupet e studimit dhe grupet e tjera dhe me përgatitjen e konferencave të radiokomunikacionit, dhe ndonjë çështje specifike ngritur nga një konferencë e Unionit, një asamble radiokomunikacioni ose nga Këshilli;

Shtuar 160CA-2002 1 bis) do të rishikojë zbatimin e planit të veprimit të periudhës së mëparshme, me qëllim që të identifikojë hapësirat në të cilat Byroja nuk ka arritur ose nuk ka mundur të arrijë objektivat e këtij plani, dhe këshillon drejtorin për korrigjime të nevojshme;

Shtuar 160D-1998 2) do të rishikojë progresin në zbatimin e programit të punës hartuar sipas nr.132 të kësaj konvente;

Shtuar 160E-1998 3) do të sigurojë udhëzime për punën e grupeve të studimit;

Shtuar 160F-1998 4) do të rekomandojë, ndërmjet të tjerash, masa për një koordinim dhe kooperim të shpejtë me ekipet e tjera të standardizimit, me Sektorin e Standardizimit të Telekomunikacionit, Sektorin e Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Sekretariatin e Përgjithshëm;

Shtuar 160G-1998 5) do të aprovojë procedurat e saj të punës, të përshtatura me ato të aprovuara nga asambleja e radiokomunikacionit;

Shtuar 160H-1998 6) do të përgatisë një raport për drejtorin e Byrosë së Radiokomunikacionit duke informuar për sa më sipër;

Shtuar 160I-2002 7) në përputhje me nr.137A të kësaj konvente, do të përgatisë një raport për Asamblenë e Radiokomunikacionit, lidhur me çështjet që i përkasin, dhe do t'ia transmetojë atë drejtorit për ta paraqitur në Asamble.

Neni 12
Byroja e Radiokomunikacionit

Ndryshuar 164-2002 a) do të koordinojë punën përgatitore të grupeve të studimit dhe grupeve të

tjera dhe Byrosë, do t'u komunikojë shteteve anëtare dhe anëtarëve të sektorit rezultatet e kësaj pune përgatitore, do të grumbullojë komentet e tyre dhe do t'i paraqesë një raport të plotë konferences, i cila mund të përfshijë propozime të një natyre rregullatore;

Ndryshuar 165-2002 b) do të marrë pjesë, sipas së drejtës, por në një kapacitet këshillues, në diskutimet e konferencave të radiokomunikacionit, të asambleve të radiokomunikacionit, si dhe të grupeve të studimit të radiokomunikacionit dhe të grupeve të tjera. Drejtori, në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm, në përputhje me nr.94 të kësaj konvente dhe, nëse është e nevojshme, me sektorët e tjerë të Unionit, dhe në përputhje të plotë me direktivat e Këshillit për kryerjen e këtyre përgatitjeve, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjet e konferencave të radiokomunikacionit dhe mbledhjet e sektorit të radiokomunikacionit;

Ndryshuar 169-2002 b) do t'u shpërndajë, të gjitha shteteve anëtare, rregullat procedurale të Bordit, do të grumbullojë komentet e dërguara nga administratat dhe do t'ia paraqesë ato Bordit;

Ndryshuar 170-2002 c) do të përpunojë informacionet e marra nga administratat në zbatim të dispozitave përkatëse të rregulloreve radio, të marrëveshjeve rajonale, si dhe të rregullave të tyre shoqëruese procedurale dhe do t'i përgatisë ato, nëse është e nevojshme, në një formë të përshtatshme për publikim;

Ndryshuar 175-2002 3) do të koordinojë punën e grupeve të studimit të radiokomunikacionit dhe grupeve të tjera dhe të jetë përgjegjës për organizimin e kësaj pune.

Ndryshuar 175A-1998 3 bis) do të sigurojë mbështetjen e nevojshme për grupin këshillues, dhe të raportojë çdo vit shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit, si dhe Këshillin për rezultatet e punës të grupit këshillues.

Ndryshuar 175B-2002 3 ter) do të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar pjesëmarrjen e vendeve në zhvillim në grupet e studimit të radiokomunikacionit dhe në grupe të tjera.

Ndryshuar 177-1998 a) kryerjen e studimeve për grumbullimin e ideve lidhur me sigurimin e operimit të një numri maksimal të mundshëm të kanaleve radio në ato porcione të spektrit ku mund të shkaktohen interferenca të dëmshme dhe me sigurimin e një përdorimi të barabartë, efektiv dhe ekonomik të orbitave të satelitëve gjeostacionarë dhe satelitëve të tjerë, duke marrë në konsideratë nevojat e shteteve anëtare që kërkojnë asistencë, nevojat specifike të vendeve në zhvillim, dhe në të njëjtën kohë situatat specifike gjeografike të vendeve të ndryshme;

Ndryshuar 178-1998 b) shkëmbimin e të dhënave me shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit, në formë elektronike apo në ndonjë formë tjetër, përgatitjen dhe ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave të sektorit të radiokomunikacionit dhe, nëse është e nevojshme, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, përgatitjen e publikimit të tyre në gjuhët e punës së Unionit, në përputhje me nr.172 të Kushtetutës;

Ndryshuar 180-2002 d) paraqitjen në konferencën botërore të radiokomunikacionit të një raporti për aktivitetet e sektorit të radiokomunikacionit që nga konferenca e fundit; nëse një konferencë botërore e radiokomunikacionit nuk është planifikuar, do të paraqitet në Këshill dhe, për informacion, në shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit, një raport mbi aktivitetet e sektorit që mbulojnë periudhën që nga konferenca e fundit;

Ndryshuar 181A-2002 f) përgatitjen çdo vit të një plani veprimi katërvjeçar që mbulon vitin në vazhdim dhe periudhën e mëtejshme trevjeçare, duke përfshirë termat financiarë të aktiviteteve që duhet të ndërmerren nga Byroja në mbështetje të gjithë sektorit; ky plan veprimi katërvjeçar do të rishikohet nga grupi këshillues, në përputhje me nenin 11A të kësaj konvente, dhe do të rishikohet dhe aprovohet çdo vit nga Këshilli;

SEKSIONI 6
SEKTORI I STANDARDIZIMIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Neni 13
PP-98 **Asambleja Botërore e Standardizimit të Telekomunikacionit**

Ndryshuar 184-1998 1. Në përputhje me nr.104 të Kushtetutës, një asamble botërore e standardizimit të telekomunikacionit do të mblidhet për të trajtuar çështje specifike që lidhen me standardizimin në telekomunikacion.

Ndryshuar 184A-2002 1bis Asambleja Botërore e Standardizimit të Telekomunikacionit është e autorizuar të miratojë metodat e punës dhe procedurat për menaxhimin e aktiviteteve të sektorit, në përputhje me nr.145A të Kushtetutës.

Ndryshuar 185-1998 2. Çështjet që do të studiohen nga një asamble botërore e telekomunikacionit, mbi të cilat do të dalin rekomandimet, do të adoptohen në pajtim me procedurat e saj ose do t'u referohen konferencave të të plotfuqishmëve, ndonjë konference tjetër ose Këshillit.

Ndryshuar 186-1998 3. Në përputhje me nr.104 të Kushtetutës, Asambleja do të:

Ndryshuar 187-2002 a) marrë në konsideratë raportet e grupeve të studimit, përgatitur në përputhje me nr.194 të kësaj konvente dhe do të aprovojë, modifikojë ose hedhë poshtë draft rekomandimet që përmbajnë këto raporte, dhe do të marrë në konsideratë raportet e grupit këshillues të standardizimit të telekomunikacionit, në përputhje me nr.197H dhe 197I të kësaj konvente;

(Ndryshuar)190-1998 d) do të grumbullojë, brenda mundësive, çështjet në interes të vendeve në zhvillim për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në këto studime;

Shtuar 191bis-2002 f) do të vendosë në rast nevoje të mirëmbajë, përfundojë ose krijojë grupe të tjera dhe do të caktojë kryetarin dhe nënkryetarin e tyre;

Shtuar 191ter-2002 g) do të krijojë termat e referencës për grupet, referuar në nr.191bis më sipër; grupe të tilla nuk do të miratojnë çështje ose rekomandime.

Ndryshuar 191A-1998 4. Një asamble botërore e standardizimit të telekomunikacionit mund të përcaktojë, brenda kompetencave të saj, çështje specifike për grupin këshillues të standardizimit të telekomunikacionit duke udhëzuar veprimet që duhen ndërmarrë.

Ndryshuar 191B-2002 5. Një asamble botërore e standardizimit të telekomunikacionit do të drejtohet nga një kryetar i caktuar nga qeveria e vendit në të cilën do të zhvillohet mbledhja ose në rastin kur mbledhja zhvillohet në selinë e Unionit, nga kryetari i zgjedhur nga vetë asambleja. Kryetari do të ndihmohet nga nënkryetari i zgjedhur nga asambleja.

Neni 14
Grupet e studimit të standardizimit të telekomunikacionit

Ndryshuar 192-1998 1.1) Grupet e studimit të standardizimit të telekomunikacionit do të studiojnë çështje, të aprovuara në përputhje me një procedurë të krijuar nga Asambleja Botërore e Standardizimit të Telekomunikacionit, dhe do të përgatisin draftrekomandimet që aprovohen në përputhje me procedurat e sqaruara në nr.246A deri në 247 të kësaj konvente.

Ndryshuar 194-1998 3) Çdo grup studimi do të përgatisë për Asamblenë Botërore të Standardizimit të Telekomunikacionit një raport që tregon progresin e punës, rekomandimet e aprovuara në përputhje me procedurat konsultuese që përmbahen në nr.192 më sipër, ndonjë draft të ri ose rekomandime të rishikuara për t'u marrë në konsideratë nga asambleja.

Ndryshuar 197-1998 4. Me qëllim lehtësimin e punës për rishikimin e aktiviteteve në Sektorin e Standardizimit të Telekomunikacionit, do të merren masa për një kooperim dhe koordinim të shpejtë me organizatat që punojnë për standardizimin e telekomunikacionit, me sektorin e radiokomunikacionit dhe sektorin e zhvillimit të telekomunikacionit. Një asamble e standardizimit të telekomunikacionit do të përcaktojë detyrat specifike, kushtet e pjesëmarrjes dhe rregullat e procedurës për këto masa.

Neni 14 A
PP-98 **Grupi këshillues i standardizimit të telekomunikacionit**

Ndryshuar 197A-2002 1. Grupi këshillues i standardizimit të telekomunikacionit do të jetë i hapur për përfaqësuesit e administratave të shteteve anëtare dhe përfaqësuesit e anëtarëve të sektorit dhe kryetarët e grupeve të studimit dhe grupeve të tjera.

Ndryshuar 197D-1998 2. Grupi këshillues i standardizimit të telekomunikacionit do të:

Ndryshuar 197E-1998 1) do të rishikojë prioritetet, programet, veprimet, çështjet dhe strategjitë financiare për aktivitetet në Sektorin e Standardizimit të Telekomunikacionit;

Shtuar 197 CA-2002 1bis) do të rishikojë zbatimin e planit veprues të periudhës së mëparshme me qëllim që të identifikojë hapësirat në të cilat byroja nuk ka arritur ose nuk ka mundur të arrijë objektivat e vendosura në këtë plan, dhe këshillon drejtorin për korrigjime të nevojshme.

Ndryshuar 197F-1998 2) do të rishikojë progreset në zbatimin e programeve të punës, hartuara nën nr.188 të kësaj konvente;

Ndryshuar 197G-1998 3) do të sigurojë udhëzime për punën e grupeve të studimit;

Ndryshuar 197H-1998 4) do të rekomandojë, ndërmjet të tjerash, masa për një kooperim dhe koordinim të shpejtë me ekipe që kryejnë funksione që lidhen me standardizimet në telekomunikacione, me sektorin e radiokomunikacionit, me Sektorin e Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Sekretariatin e

Përgjithshëm;

Ndryshuar 197I-1998 5) do të aprovojë procedurat e punës së tij të përshtatura me ato që janë aprovuar nga Asambleja e Standardizimit të Telekomunikacionit;

Ndryshuar 197J-1998 6) do të përgatisë një raport për drejtorin e Byrosë së Standardizimit të Telekomunikacionit duke treguar veprimet lidhur me çështjet e mësipërme;

Ndryshuar 197K-1998 7) do të përgatisë një raport për Asamblenë e Standardizimit të Telekomunikacionit për çështjet e caktuara për ndjekje nga ana e tij, në përputhje me nr.191A dhe do t'i transmetojë ato te drejtori për t'ia paraqitur Asamblesë.

Neni 15

Byroja e Standardizimit të Telekomunikacionit

Ndryshuar 200-2002 a) të rinovojë çdo vit programin e punës të aprovuar nga Asambleja Botërore e Standardizimit në Telekomunikacion, në konsultim me kryetarin e grupeve të studimit të standardizimit të telekomunikacionit dhe grupet e tjera;

Ndryshuar 201-2002 b) të marrë pjesë, sipas së drejtës, por në kapacitet këshillues, në diskutimet e asambleve botërore të standardizimit të telekomunikacioneve, të grupeve të studimit të standardizimit të telekomunikacioneve dhe grupeve të tjera. Drejtori do të sigurojë të gjitha përgatitjet e nevojshme për asambletë dhe mbledhjet e sektorit të standardizimit të telekomunikacionit në konsultim me Sekretariatin e Përgjithshëm, në përputhje me nr.94 të kësaj konvente dhe, nëse është e nevojshme, me sektorët e tjerë të Unionit, duke u bazuar në direktivat e Këshillit lidhur me këto përgatitje;

Ndryshuar 202-1998 c) të përpunojë informacionin e marrë nga administratat në zbatim të dispozitave përkatëse të rregulloreve ndërkombëtare të telekomunikacionit ose vendimeve të Asamblesë Botërore të Standardizimit të Telekomunikacionit dhe t'i përgatisë ato, nëse është e nevojshme, në një formë të përshtatshme për publikim;

Ndryshuar 203-1998 d) të shkëmbejë të dhëna, në mënyrë elektronike ose në forma të tjera, me shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit, të përgatisë dhe, kur të nevojitet, të ruajë dokumentet dhe të dhënat e sektorit të standardizimit të telekomunikacionit, dhe të përgatisë, së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm, nëse kërkohet, publikimin e tyre në gjuhët e punës së Unionit në përputhje me nr.172 të Kushtetutës;

Ndryshuar 204-1998 e) të paraqesë në Asamblenë e Standardizimit të Telekomunikacionit një raport për aktivitetet e sektorit që nga asambleja e fundit; Drejtori do t'i paraqesë, gjithashtu, Këshillit dhe shteteve anëtare, si dhe anëtarëve të sektorit një raport të tillë që mbulon periudhën dyvjeçare që nga asambleja e fundit, deri sa të mblidhet një asamble e dytë.

Ndryshuar 205A-2002 f bis) të përgatisë çdo vit një plan veprimi katërvjeçar që mbulon vitin pasardhës dhe periudhën trevjeçare në vazhdim, duke përfshirë termat financiarë të aktiviteteve që ndërmerren nga Byroja në mbështetje të gjithë sektorit; ky plan veprimi katërvjeçar do të rishikohet nga grupi këshillues i standardizimit të telekomunikacionit në përputhje me nenin 14A të kësaj konvente, dhe do të rishikohet dhe aprovohet çdo vit nga Këshilli;

Ndryshuar 205B-1998 g) të sigurojë mbështetjen e nevojshme për grupin këshillues të standardizimit të telekomunikacionit dhe u raporton çdo vit shteteve anëtare, anëtarëve të sektorit dhe Këshillit për rezultatet e punës së saj;

Ndryshuar 205C-1998 h) të sigurojë asistencë për vendet në zhvillim në punët përgatitore për asambletë botërore të standardizimit, veçanërisht për çështjet me natyrë prioritare për këto vende.

SEKSIONI 7

SEKTORI I ZHVILLIMIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Neni 16

PP-98 **Konferencat e zhvillimit të telekomunikacionit**

Shtuar 207A-2002 1.Konferenca botërore e zhvillimit të telekomunikacionit është e autorizuar të miratojë metodat e punës dhe procedurat për menaxhimin e aktiviteteve të sektorit në përputhje me nr.145A të Kushtetutës.

Shtuar 209A-2002 a bis) të vendosë, në rast nevoje, të mirëmbajë, shpërndajë ose krijojë grupe të tjera dhe të caktojë kryetarin dhe nënkryetarin e tyre.

Shtuar 209B-2002 a ter) të krijojë termat e referencës për grupet referuar nr.209A më sipër; të tilla grupe nuk do të miratojnë çështje ose rekomandime.

Ndryshuar 210-2002 b) konferencat rajonale të zhvillimit të telekomunikacionit duhet të marrin në konsideratë çështjet dhe prioritetet lidhur me zhvillimet e telekomunikacioneve, duke marrë parasysh nevojat dhe karakteristikat e rajonit përkatës, dhe mund të pranojnë, gjithashtu rekomandimet e konferencave të zhvillimit të telekomunikacionit mbarëbotëror;

Ndryshuar 213-1998 2. Draftaxhenda e konferencave do të përgatitetet nga drejtori i Byrosë së Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm për t'u aprovuar në Këshill me mbështetjen e maxhorancës së shteteve anëtare që i përkasin rajonit në fjalë në rastin e një konference rajonale, subjekt i kërkesave të nr.47 të kësaj konvente.

Ndryshuar 213A-2002 3. Konferenca e zhvillimit të telekomunikacionit mund të përcaktojë çështjet specifike brenda kompetencave të saj për grupin këshillues të zhvillimit telekomunikacionit, duke treguar veprimet e rekomanduara për këto çështje.

Neni 17

Grupet e studimit të zhvillimit të telekomunikacionit

Ndryshuar 215A-1998 3. Çdo grup studimi i zhvillimit të telekomunikacionit do të përgatisë, për konferencën botërore të zhvillimit të telekomunikacionit, një raport që tregon programet e punës dhe ndonjë draft të ri ose rekomandime të rishikuara për t'u trajtuar nga kjo konferencë.

Ndryshuar 215B-1998 4. Grupet e studimit të zhvillimit të telekomunikacionit do të studiojnë çështjet dhe do të përgatisin draftrekomandimet që do të jenë aprovuar në përputhje me procedurat e vendosura në nr.246A deri 247 të kësaj konvente.

Neni 17A

PP-98 **Grupi këshillues i zhvillimit të telekomunikacionit**

Ndryshuar 215C-2002 1. Grupi këshillues i zhvillimit të telekomunikacionit do të jetë i hapur për përfaqësuesit e administratave të shteteve anëtare dhe përfaqësuesit e anëtarëve të sektorit dhe kryetarët e grupeve të studimit dhe grupeve të tjera.

Shtuar 215D-1998 8. Grupi këshillues i zhvillimit të telekomunikacionit:

Shtuar 215E-1998 1) do të rishikojë prioritetet, programet, veprimet, çështjet financiare dhe strategjitë për aktivitetet në sektorin e zhvillimit të telekomunikacionit;

Shtuar 215EA-2002 1bis) do të rishikojë zbatimin e planit veprues të periudhës së mëparshme me qëllim që të identifikojë hapësirat në të cilat Byroja nuk ka arritur ose nuk ka mundur të arrijë objektivat e vendosura në këtë plan, dhe këshillon drejtorin për korrigjime të nevojshme;

Shtuar 215F-1998 2) do të rishikojë progresin në zbatimin e programit të punës hartuar në bazë të nr.209 të kësaj konvente;

Shtuar 215 G-1998 3) do të sigurojë udhëzime për punën e grupeve të studimit;

Shtuar 215H-1998 4) do të rekomandojë, ndërmjet të tjerash, masa për një kooperim dhe koordinim të shpejtë me sektorin e radiokomunikacionit, sektorin e standardizimit të telekomunikacionit dhe Sekretariatin e Përgjithshëm, gjithashtu me institucionet e tjera financiare dhe të zhvillimit;

Shtuar 215I-1998 5) do të aprovojë procedurat e punës së saj të përshtatura me ato të aprovuara nga konferenca botërore e zhvillimit të telekomunikacionit;

Shtuar 215J-1998 6) do të përgatisë një raport për drejtorin e Byrosë së Zhvillimit të Telekomunikacionit për ta informuar përsa u përmend më sipër;

Shtuar 215JA-1998 6 bis) do të përgatisë, në përputhje me nr.213 të kësaj konvente, një raport për konferencën botërore të zhvillimit të telekomunikacionit për çështjet që trajton ajo dhe do t'i transmetojë atë drejtorit për ta paraqitur në konferencë;

Shtuar 215K-1998 9. Drejtori mund të ftojë, për të marrë pjesë në mbledhjet e grupit këshillues, përfaqësuesit e kooperimeve dypalëshe, agjencive në ndihmë të zhvillimit dhe institucioneve shumëpalëshe të zhvillimit.

Neni 18

Byroja e Zhvillimit të Telekomunikacionit

Ndryshuar 218-2002 a) marrë pjesë, si e drejtë, por në kapacitet këshillues, në diskutimet e asambleve botërore të standardizimit të telekomunikacioneve, të grupeve të studimit të standardizimit të

telekomunikacioneve dhe grupeve të tjera. Drejtori do të sigurojë të gjitha përgatitjet e nevojshme për asambletë dhe mbledhjet e sektorit të zhvillimit të telekomunikacionit në konsultim me Sekretariatin e Përgjithshëm, në përputhje me nr.94 të kësaj konvente, dhe, nëse është e nevojshme, me sektorët e tjerë të Unionit, duke marrë për bazë direktivat e Këshillit lidhur me këto përgatitje.

Ndryshuar 222-1998 e) paraqesë në konferencën botërore të zhvillimit të telekomunikacionit një raport për aktivitetet e sektorit që nga konferenca e fundit; Drejtori do t'i paraqesë gjithashtu Këshillit, shteteve anëtare dhe anëtarëve të sektorit një raport të tillë që mbulon periudhën dyvjeçare që nga konferenca e fundit;

(Ndryshuar) 223-1998 f) përgatisë një vlerësim të buxhetit bazuar në kosto për dispozitat e sektorit të zhvillimit të telekomunikacionit dhe ia transmeton atë Sekretarit të Përgjithshëm, i cili ia kalon, për trajtim për përfshirje në buxhetin e Unionit, Komitetit Koordinativ dhe;

Ndryshuar 223A-2002 f bis) përgatisë çdo vit një plan veprimi katërvjeçar që mbulon vitin pasardhës dhe periudhën trevjeçare në vazhdim, duke përfshirë termat financiarë të aktiviteteve që ndërmerren nga Byroja në mbështetje të gjithë sektorit; ky plan veprimi katërvjeçar do të rishikohet nga grupi këshillues i zhvillimit të telekomunikacionit në përputhje me nenin 17A të kësaj konvente, dhe do të rishikohet dhe aprovohet çdo vit nga Këshilli;

Ndryshuar 223B-1998 g) sigurojë mbështetjen e nevojshme për grupin këshillues të zhvillimit të telekomunikacionit dhe do të raportojë çdo vit shtetet anëtare dhe Këshillin për rezultatet e punës së saj.

Ndryshuar 224-1998 3. Drejtori do të punojë kolegjialisht me zyrtarët e tjerë të zgjedhur, me qëllim që roli katalizues i Unionit në stimulimin e zhvillimit të telekomunikacionit të fuqizohet dhe të mundësojë marrëveshje me drejtorin e Byrosë që lidhen me fillimin e veprimeve të nevojshme, duke përfshirë organizimin e mbledhjeve informuese për aktivitetet e sektorit përkatës.

Ndryshuar 225-1998 4. Me kërkesë të Sshteteve anëtare, drejtori, me ndihmën e drejtorëve të byrove të tjera dhe, kur është e nevojshme, e Sekretarit të Përgjithshëm, do të studiojnë dhe ofrojnë këshilla, lidhur me problemet e tyre kombëtare në fushën e telekomunikacionit. Në rastin e krahasimeve të alternativave teknike, do të merren në konsideratë faktorët ekonomikë.

Hequr 227-1998

Neni 19

Pjesëmarrja e enteve dhe organizatave të tjera nga administratat në aktivitetet e Unionit

Ndryshuar 229-1998 a) agjencitë e njohura operuese, organizatat shkencore ose industriale dhe institucionet financiare ose të zhvillimit të cilat janë aprovuar nga shteti anëtar përkatës;

Ndryshuar 230-1998 b) ente të tjera që trajtojnë çështje të telekomunikacionit që janë aprovuar nga Shteti Anëtar përkatës;

Ndryshuar 233-1998 3. Çdo kërkesë, në përputhje me dispozitat përkatese të Kushtetutës dhe kësaj Konventë dhe e aprovuar nga shteti anëtar përkatës, nga secili nga entet e renditura në nr.229 më sipër, për të marrë pjesë në punën e një sektori do t'i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm.

Ndryshuar 234-1998 4. Çdo kërkesë nga një ent referuar nr.230 më sipër, paraqitur nga shteti anëtar përkatës; do të trajtohet në konformitet me procedurën e përcaktuar nga Këshilli. Një kërkesë e tillë do të rishikohet nga Këshilli nga pikëpamja e përshtatjes së saj me procedurën e mësipërme.

Ndryshuar 234A-1998 4bis. Nga ana tjetër, kërkesa që bën secili prej enteve, e renditur në nr.229 ose 230 më sipër, për t'u bërë anëtar sektori mund t'i dërgohet direkt Sekretarit të Përgjithshëm. Ato shtete anëtare që autorizojnë të tilla ente të dërgojnë një kërkesë direkt te Sekretari i Përgjithshëm, do të informohen më vonë. Entet, për të cilat shteti anëtar nuk ka njoftuar për sa më sipër Sekretarin e Përgjithshëm, nuk kanë të drejtën e aplikimeve direkte. Sekretari i Përgjithshëm, do të rifreskojë rregullisht dhe do të publikojë listën e atyre shteteve anëtare që kanë ente të autorizuara nën juridiksionin ose sovranitetin e tyre të aplikojnë direkt.

Ndryshuar 234B-1998 4 ter. Me marrjen e kërkesës dërguar direkt nga një ent në zbatim të nr.234A më sipër, Sekretari i Përgjithshëm, në bazë të kritereve të përcaktuara nga Këshilli, do të sigurohet që funksioni dhe qëllimet e kandidatit janë në konformitet me qëllimet e Unionit. Sekretari i Përgjithshëm atëherë, pa vonesë, do të informojë shtetin anëtar të aplikantit duke i bërë ftesë të aprovojë aplikimin. Në qoftë se Sekretari i Përgjithshëm nuk merr kundërshtime nga shteti anëtar brenda katër muajve, dërgon një telegram rikujtues. Në qoftë se Sekretari i Përgjithshëm nuk merr kundërshtime nga shteti anëtar brenda katër muajve nga data e dërgimit të telegramit, aplikimi do të konsiderohet i aprovuar. Nëse Sekretari i Përgjithshëm merr një vërejtje nga shteti anëtar, ai fton aplikantin të kontaktojë me shtetin anëtar përkatës.

Ndryshuar 234C-1998 4 quater. Kur autorizon një aplikim direkt, një shtet anëtar mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që i kalon atij autoritetin për të aprovuar ndonjë aplikim nga çdo ent nën juridiksionin dhe sovranitetin e tij.

Ndryshuar 237-1998 7. Sekretari i Përgjithshëm mund të grumbullojë dhe mirëmbajë listën e të gjitha enteve dhe organizatave që, referuar nr.229 deri 231 dhe nr.260 deri 262 të kësaj Konvente, janë autorizuar të marrin pjesë në punën e çdo sektori dhe do të publikojë dhe shpërndajë këto lista, në një interval të përshtatshëm, te të gjitha shtetet anëtare, te anëtarët e sektorit dhe drejtorët përkatës të byrove. Drejtori do të këshillojë këto ente dhe organizata për veprimet e ndërmarra me kërkesë të tyre, dhe do të informojë shtetet anëtare përkatëse.

Ndryshuar 238-1998 8. Kushtet që duhet të plotësojnë entet dhe organizatat, që përfshihen në listat referuar nr.237, për pjesëmarrje në sektorë janë specifikuar në këtë nen, në nenin 33 dhe në dispozitat e tjera përkatëse të kësaj Konvente. Në këtë rast nuk zbatohen dispozitat e nr.25 deri 28 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 239-1998 9. Një anëtar sektori mund të veprojë në emër të shtetit anëtar me autorizimin e tij, vetëm pasi ky shtet anëtar ka informuar drejtorin e byrosë përkatëse për këtë autorizim.

Ndryshuar 240-1998 10. Një anëtar sektori ka të drejtën të heqë dorë nga një pjesëmarrje e tillë nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo pjesëmarrje mund të anulohet, gjithashtu, nga shteti anëtar përkatës kur ai e shikon të nevojshme ose, në rastin e miratimit të anëtarit të sektorit sipas nr.234 C më sipër, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli. Një anulim i tillë do të ketë efekt një vit nga data e njoftimit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Ndryshuar 241A-1998 Asambleja ose konferenca e sektorit mund të vendosë të pranojë entet dhe organizatat të marrin pjesë si pjesëmarrës në punën e një grupi apo nëngrupi studimi të dhënë duke ndjekur principet e renditura më poshtë:

Ndryshuar 241B-1998 1) Një ent ose organizatë referuar në nr.229 deri 231 më sipër mund të aplikojë për të marrë pjesë në punën e një grupi studimi të dhënë si një pjesëmarrës.

Ndryshuar 241C-1998 2) Në rastet kur një sektor ka vendosur të pranojë pjesëmarrje, Sekretari i Përgjithshëm do t'u kërkojë aplikantëve dispozitat përkatëse të nenit, duke marrë në konsideratë përmasat e enteve dhe organizateve dhe ndonjë kriter tjetër që lidhet me to.

Ndryshuar 241D-1998 3) Pjesëmarrësit e lejuar të marrin pjesë në një grup studimi të dhënë janë futur në listën e paraqitur në nr.237 më sipër.

Ndryshuar 241E-1998 4) Kushtet për pjesëmarrjen në punën e një grupi studimi janë specifikuar në nr.248B dhe 483A të kësaj Konvente.

Neni 20

Administrimi i detyrave të grupeve të punës

Ndryshuar 242-1998 1. Asambleja e Radiokomunikacionit, Asambleja Botërore e Standardizimit të Telekomunikacionit dhe Konferenca Botërore e Zhvillimit të Telekomunikacionit do të caktojnë kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë për çdo grup pune. Në caktimin e kryetarit dhe nënkryetarit, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet kërkesave për kompetenca dhe shpërndarje të barabartë gjeografike, dhe nevojave për nxitjen e një pjesëmarrjeje sa më efiçente të vendeve në zhvillim.

Ndryshuar 243-1998 2. Në qoftë se kërkohet përcaktimi i afateve kohore të punës së një grupi pune, Asambleja ose Konferenca, nëse e gjykojnë të nevojshme, do të caktojnë një tjetër nënkryetar.

Shtuar 246A-1998 5 bis a) Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit do të aprovojnë, në përputhje me procedurat e krijuara nga konferencat ose asambletë, çështjet që do të studiohen dhe, kur është e nevojshme, duke përfshirë tregues nëse një rekomandim përfundimtar do të jetë subjekt i një konsultimi formal të shteteve anëtare.

Shtuar 246B-1998 b) Rekomandimet që rrjedhin nga studimi i çështjeve të mësipërme aprovohen, nëse kërkohet, nga një grup studimi në përputhje me procedurat e krijuara nga konferencat ose asambletë përkatëse. Rekomandimet që nuk kërkojnë, për t'u aprovuar, konsultime formale të shteteve anëtare, do të konsiderohen të aprovuara.

Shtuar 246C-1998 c) Një rekomandim që kërkon konsultime formale të shteteve anëtare do të trajtohet, për më tepër, në përputhje me nr.247 më poshtë ose do t'i transmetohet konferencës ose asamblesë përkatëse, nëse konsiderohet e nevojshme.

Shtuar 246D-1998 e bis) Nr.246A dhe 246B, më sipër, nuk do të zbatohen për çështje dhe rekomandime që kanë nëntekste politike apo rregullatore, të tilla si:

Shtuar 246E-1998 - çështjet dhe rekomandimet e aprovuara nga sektori i radiokomunikacionit, që

lidhen me punën e konferencave të radiokomunikacionit dhe kategoritë e tjera të çështjeve dhe rekomandimeve që mund të vendosen nga Asambleja e Radiokomunkacionit;

Shtuar 246F-1998 - çështjet dhe rekomandimet e aprovuara nga sektori i standardizimit, që lidhen me probleme të tarifave dhe llogarive, dhe planet përkatëse të numeracionit dhe adresimit;

Shtuar 246G-1998 - çështjet dhe rekomandimet e aprovuara nga sektori i zhvillimit, të cilat lidhen me problemet rregullatore, politike dhe financiare;

Shtuar 246H-1998 - çështjet dhe rekomandimet për të cilat ekziston një dyshim lidhur me fushën e trajtimit të tyre.

Ndryshuar 247-1998 6. Grupet e studimit mund të fillojnë procedurat për të marrë miratimin nga shtetet anëtare për rekomandimet e kompletuara përmes dy asambleve apo konferencave. Nëse duhet, procedurat e aplikimit për të marrë një miratim të tillë do të jenë ato që janë aprovuar nga konferenca apo asambleja kompetente.

Ndryshuar 247A-1998 6 bis. Rekomandimet e aprovuara në zbatim të nr.246B ose 247 më sipër do të kenë të njëjtin status me atë të aprovuar nga vetë konferenca apo asambleja.

Ndryshuar 248A-1998 7 bis. Kur ndiqet një procedurë e krijuar nga sektori përkatës, drejtori i Byrosë, në konsultim me kryetarin e grupit përkatës të studimit, mund të ftojë një organizatë, e cila nuk merr pjesë në sektorin që dërgon përfaqësues, në studimin e një çështjeje specifike, në grupin e studimit në fjalë ose në grupet vartëse të saj.

Ndryshuar 248B-1998 7 ter. Një pjesëmarrës, referuar nr.241A të kësaj Konvente, do të jetë i lejuar të marrë pjesë në punën e grupit të zgjedhur të studimit pa marrë pjesë në ndonjë vendimmarrje të tij apo aktivitet të lidhur me të.

KAPITULLI II

Ndryshuar PP-98 **Dispozitat specifike në lidhje me konferencat dhe asambletë**

Neni 23

Ndryshuar **Lejet për konferencat e të plotfuqishmëve**

Hequr* 255 deri 266-2002

(Ndryshuar) 267-2002 1. Konferencat e të plotfuqishmëve do të lejohen nga të poshtëpërmendurit:

Shtuar 268A-2002 b) zyrtarët e zgjedhur, në një kapacitet këshillues;

Shtuar 268B-2002 c) Bordi i Rregulloreve Radio, në përputhje me nr.141A të kësaj konvente, në një kapacitet këshillues;

Ndryshuar 269-2002 d) vëzhguesit e organizatave, agjencive dhe enteve të mëposhtme:

Shtuar 269A-2002* i) Kombet e Bashkuara;

Shtuar 269B-2002* ii) organizatat rajonale të telekomunikacionit, të përmendura në nenin 43 të Kushtetutës;

Shtuar 269C-2002* iii) organizatat ndërqeveritare që operojnë me sisteme satelitore;

Shtuar 269D-2002* iv) agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike;

Shtuar 269E-2002* v) Anëtarët e sektorit, referuar në nr.229 dhe 231 të kësaj konvente, dhe organizatat e një karakteri ndërkombëtar që i përfaqësojnë ata;

Shtuar 269F-2002* 2. Sekretari i Përgjithshëm dhe tri byrotë e Unionit do të përfaqësohen në konferencë në kapacitet këshillues.

Neni 24

Ndryshuar **Lejet për konferencat e radiokomunikacionit**

Hequr* 270 deri 275-2002

(Ndryshuar) 276-2002 1. Konferencat e radiokomunikacionit do të lejohen nga të poshtëpërmendurit:

(Ndryshuar) 278-2002 b) vëzhguesit e organizatave dhe agjencive, referuar në nr.269A deri 269D të kësaj konvente;

Ndryshuar 279-2002 c) vëzhgues nga organizata të tjera internacionale, të ftuar nga qeveria dhe të lejuar nga konferenca, në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 1 të rregullave të përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit;

Ndryshuar 280-1998 d) vëzhgues që përfaqësojnë anëtarët e sektorit të radiokomunikacionit të autorizuar sipas rregullave nga shteti anëtar përkatës;

Hequr* 281-2002

(Ndryshuar) 282-2002 e) vëzhgues nga shtetet anëtare të rajoneve të tjera, që marrin pjesë në një kapacitetet jovotues, në një konferencë rajonale të radiokomunikacionit të një rajoni tjetër.

Shtuar 282A -2002* f) në një kapacitet këshillues, zyrtarët e zgjedhur, kur konferenca diskuton çështje që janë brenda kompetencave të tyre, dhe anëtarët e Bordit të Rregulloreve Radio.

Neni 25

Ndryshuar PP-98 **Lejet për asambletë e radiokomunikacionit, asambletë botërore të standardizimit të telekomunikacionit dhe konferencat e zhvillimit të telekomunikacionit**

Hequr* 283 deri 294-2002

(Ndryshuar) 295-2002 1. Asambletë ose konferencat do të lejohen nga të poshtëpërmendurit:

Ndryshuar 297-2002 b) vëzhguesit e organizatave dhe agjencive të mëposhtme:

Hequr* 298 -2002

Shtuar 298A-2002* i) organizatat rajonale të telekomunikacionit të përmendura në nenin 43 të Kushtetutës;

Shtuar 298B-2002* ii) organizatat ndërqeveritare që operojnë me sisteme satelitore;

Shtuar 298C-2002* iii) ndonjë organizatë tjetër rajonale ose organizatë tjetër ndërkombëtare që ndjek çështje të cilat janë në interes të asamblesë ose konferencës;

Shtuar 298D-2002* iv) Kombet e Bashkuara;

Shtuar 298E-2002* v) agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike;

Shtuar 298F-2002* c) përfaqësuesit e anëtarëve të sektorit përkatës;

Shtuar 298G-2002 2. Zyrtarët e zgjedhur, Sekretariati i Përgjithshëm dhe Byroja e Unionit, nëse është e nevojshme, do të përfaqësohen në asamble ose konferencë në një kapacitet këshillues. Dy anëtarët e Bordit të Rregulloreve Radio, caktuar nga Bordi, do të marrin pjesë në asambletë e radiokomunikacionit në një kapacitet këshillues.

Hequr*-2002 Neni 26

Hequr* -2002 Neni 27

Hequr* -2002 Neni 28

Hequr* -2002 Neni 29

Hequr* -2002 Neni 30

Neni 31

Kredencialet për konferencat

Ndryshuar 324-1998 1. Delegacioni i dërguar nga një shtet anëtar në një konferencë të të plotfuqishmëve, në një konferencë radiokomunikacioni ose në një konferencë botërore të telekomunikacionit ndërkombëtar do të akreditohet sipas rregullave, në përputhje me nr.325 deri 331 më poshtë.

Ndryshuar 327-1998 3) Subjekt i konfirmimit përpara nënshkrimit të akteve finale, nga një prej autoriteteve të përmendura në nr.325 ose 326 më sipër, një delegacion mund të jetë i akredituar përkohësisht nga kryetari i misionit diplomatik të shtetit anëtar përkatës të qeverisë pritëse. Në rastin e një konference të organizuar në Konfederatën Zvicerane, një delegacion mund të jetë akredituar, gjithashtu, përkohësisht nga kryetari i delegacionit të përhershëm të shtetit anëtar përkatës në Zyrat e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë:

Ndryshuar 332-1998 4 1) Një delegacioni, kredencialet e të cilit janë konsideruar të rregullta nga mbledhja plenare, do të lejohet të ushtrojë të drejtat e votës të shtetit anëtar përkatës, subjekt i dispozitave të nr.169 dhe 210 të Kushtetutës, dhe të firmosë aktet finale.

Ndryshuar 334-1998 5. Kredencialet do të depozitohen në Sekretariatin e Konferencës sa më shpejt të jetë e mundur; në rast të fundit, shtetet anëtare do të dërgojnë kredencialet e tyre, para datës së hapjes së konferencës, në Sekretariatin e Përgjithshëm i cili do t'ia transmetojë ato sekretariatit të konferencës, kur të krijohet. Komitetit do t'i delegohet, referuar në nr.68 të rregullave të përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit, verifikimi dhe raportimi në mbledhjen plenare, brenda kohës së specifikuar, i konkluzioneve. Në pritje të vendimit të mbledhjes plenare, ndonjë delegati do t'i jepet e drejta të marrë pjesë në konferencë dhe të ushtrojë të drejtën e votës për shtetin anëtar në fjalë.

Ndryshuar 335-1998 6. Si një rregull i përgjithshëm, shtetet anëtare duhet të përpiqen t'i dërgojnë delegacionet e tyre në konferencat e Unionit. Megjithatë, në qoftë se një shtet anëtar nuk ka mundësi, për arsye të veçanta, të dërgojë delegacionin e tij, ai mund t'i kalojë delegacionit të një shteti anëtar tjetër të drejtën të votojë dhe nënshkruajë në emër të tij. Një e drejtë e tillë jepet nëpërmjet një instrumenti të nënshkruar nga një prej autoriteteve të përmendura në nr.325 ose 326 më sipër.

Ndryshuar 339-1998 10. Një shtet anëtar ose një ent apo organizatë e autorizuar, që ka ndërmend të dërgojë një delegacion ose përfaqësues në një asamble të standardizimit të telekomunikacionit, në një konferencë të zhvillimit të telekomunikacionit ose në një asamble radiokomunikacioni, do të informojë, gjithashtu, drejtorin e byrosë të sektorit përkatës, duke informuar mbi emrat dhe funksionet e anëtarëve të delegacionit ose të përfaqësuesve.

KAPITULLI III
RREGULLAT E PROCEDURËS

Neni 32
Ndryshuar

Rregullat procedurale të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit

Ndryshuar 339A-2002 Rregullat procedurale të konferencave dhe mbledhjeve të tjera aprovohen nga konferenca e të plotfuqishmëve. Dispozitat që drejtojnë procedurën për amendimin e këtyre rregullave procedurale dhe hyrja në forcë e amendimeve përmbahen në vetë këto rregulla.

Ndryshuar 340-2002 2. Rregullat e përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit do të aplikohen pa dëmtuar dispozitat e amenduara që përmban neni 55 i Kushtetutës dhe neni 42 i kësaj konvente.

Neni 32 A
E drejta e votës

Shtuar 340A-1998 1. Në të gjitha mbledhjet e konferencës, asamblesë ose mbledhjet e tjera, delegacioni i shtetit anëtar, i cili është i akreditуar sipas rregullave të marrë pjesë në punët e konferencës, asamblesë ose mbledhjeve të tjera, do t'i jepet e drejta me një votë, në përputhje me nenin 3 të Kushtetutës.

Shtuar 340B-1998 2. Delegacioni i shtetit anëtar do të ushtrojë të drejtën e votës, nën kushtet e përshkruara në nenin 31 të kësaj konventë.

Shtuar 340C-1998 3. Kur një shtet anëtar nuk përfaqësohet nga një administratë në Asamblenë e Radiokomunikacionit, në Asamblenë Botërore të Standardizimit të Telekomunikacionit ose Konferencën e Zhvillimit të Telekomunikacionit, përfaqësuesve të agjencive të njohura operuese të Shteteve Anëtare përkatëse do t'u jepet e drejta e plotë, pa pasur parasysh numrin e tyre, me një votë të vetme, në zbatim të dispozitës nr.239 të kësaj Konvente. Dispozitat nr.335 deri 338 të kësaj Konvente në lidhje me transferimin e fuqive do të zbatohen në konferencat dhe asambletë e mësipërme.

Neni 32 B
Shtuar

Rezervimi

Shtuar 340A-1998 1. Në të gjitha mbledhjet e konferencës, asamblesë ose mbledhjet e tjera, delegacioni i një shteti anëtar i akreditуar sipas rregullave nga ai shtet anëtar që merr pjesë në punën e konferencës, asamblesë ose mbledhjeve të tjera do t'i jepet e drejta me një votë, në përputhje me nenin 3 të Kushtetutës.

Shtuar 340E-1998 2. Gjatë një konference të të plotfuqishmëve, çdo shtet anëtar që ka të drejtën të bëjë rezervë siç specifikohet në deklarimin e tij kur nënshkruan aktet finale, mund të bëjë këto rezerva në lidhje me një amendim të Kushtetutës ose të kësaj konvente deri në një kohë të tillë kur instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi janë depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Shtuar 340F-1998 3. Nëse ndonjë vendim i dalë nga një delegacion është i tillë që mënjanon qeverinë e tij nga miratime që janë të kufizuara nga rregulloret e rishikuara administrative, ky delegacion

mund të bëjë rezervë, finale ose të përkohshme në lidhje me këtë vendim, në përfundim të konferencës që aprovon këtë rishikim; ndonjë rezervë e tillë mund të bëhet nga ndonjë delegacion në emër të shtetit anëtar i cili nuk merr pjesë në konferencën kompetente dhe që ia ka kaluar, me autorizim, delegacionit fuqinë e tij për të firmosur aktet finale, në përputhje me dispozitat e nenit 31 të kësaj konvente.

Shtuar 340G-1998 4. Një rezervë e bërë gjatë një konference do të jetë e vlefshme vetëm nëse shteti anëtar i cili e bën atë formalisht, e konfirmon atë duke njoftuar miratimin e tij të kufizuar nga amendimi ose rishikimi i instrumentit të aprovuar nga konferenca në mbyllje të së cilës ajo bën rezervat në fjalë.

Hequr 341 deri 467-1998

KAPITULLI IV
DISPOZITA TË TJERA

Neni 33
Financa

Ndryshuar 468-1998 1) Shkalla nëpërmjet së cilës çdo shtet anëtar, subjekt i dispozitave të nr.468A më poshtë, dhe çdo anëtar sektori, subjekt i dispozitave të nr.468B më poshtë, do të zgjedhë klasën e tij të kontributit, në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit 28 të Kushtetutës, do të jetë si më poshtë:

klasa 40 njësi	klasa 8 njësi
klasa 35 njësi	klasa 5 njësi
klasa 30 njësi	klasa 4 njësi
klasa 28 njësi	klasa 3 njësi
klasa 25 njësi	klasa 2 njësi
klasa 23 njësi	klasa 1 1/2 njësi
klasa 20 njësi	klasa 1 njësi
klasa 18 njësi	klasa 1/2 njësi
klasa 15 njësi	klasa 1/4 njësi
klasa 13 njësi	klasa 1/8 njësi
klasa 10 njësi	klasa 1/16 njësi

Shtuar 468A-1998 1bis) Vetëm Shtetet anëtare të futura në listën e Kombeve të Bashkuara si të paktën vendet e zhvilluara ose ato të përcaktuara nga Këshilli mund të zgjedhin klasat me njësi 1/8 dhe 1/16 të kontributit.

Ndryshuar 469-1998 2) Në shtesë të klasave të kontributit që ndodhen në listën nr.468 më sipër, ndonjë shtet anëtar ose anëtar sektori mund të zgjedhin një nga numrat e mësipërm të njësisë të kontributit.

Ndryshuar 470-1998 3) Sekretari i Përgjithshëm do t'i komunikojë menjëherë çdo shteti anëtar, që nuk përfaqësohet në konferencën e të plotfuqishmëve, vendimin e çdo shteti anëtar, si dhe klasën e kontributit që duhet paguar prej tij.

Hequr 471-1998

Ndryshuar 472-1998 2 1) Çdo shtet i ri anëtar apo anëtar i ri sektori, në varësi të vitit të pranimit të tij, do të paguajë, një kontribut të llogaritur që nga dita e parë e muajit të pranimit.

Ndryshuar 473-1998 2) Kur një shtet anëtar nuk pranon Kushtetutën apo këtë konventë ose kur një anëtar sektori anulon pjesëmarrjen e tij në një sektor, kontributi i tij do të paguhet deri në ditën e fundit të muajit në të cilin një mospranim i tillë është bërë efektiv në përputhje, respektivisht, me nr.237 të Kushtetutës ose nr.240 të kësaj konventë.

Ndryshuar 474-1998 3. Kuota e anëtarësisë do të bartë interesin nga fillimi i muajit të katërt të çdo viti financiar të Unionit në 3% (tre për qind) për vit gjatë tremujorit në vazhdim dhe në 6% (gjashtë për qind) për vit nga fillimi i muajit të shtatë.

Hequr 475-1998

Ndryshuar 476-2002 4 1 Organizatat, referuar në nr.269A deri 269E të kësaj konvente, dhe organizatat e tjera të një karakteri ndërkombëtar (të paktën ato që janë përjashtuar nga Këshilli, subjekt i reciprocitetit) dhe anëtarët e sektorit të cilët marrin pjesë në konferencat e të plotfuqishmëve, në një konferencë, asamble ose mbledhje të një sektori të Unionit, ose në një konferencë botërore të telekomunikacioneve ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e kësaj konvente, do të mbulojnë

bashkërisht shpenzimet e konferencave, asambleve dhe mbledhjeve në të cilat ato marrin pjesë në bazë të kostove të këtyre konferencave dhe mbledhjeve dhe në përputhje me rregulloret financiare. Megjithatë, anëtarët e sektorit nuk do të ngarkohen individualisht për ndjekjen e një konference, asambleje ose mbledhjeje të sektorëve të tyre reciprokë, përveçse në rastin e konferencave rajonale të radiokomunikacionit.

Ndryshuar 477-1998 2) Ndonjë anëtar sektori që ndodhet në një nga listat e përmendura në nr.237 të kësaj konvente do të kontribojë në pagesat e shpenzimeve të sektorit në përputhje me nr.480 dhe 480A më poshtë.

Hequr 478 dhe 479-1998

Ndryshuar 480-1998 5) Vlera e kontributit për njësi që paguhet për shpenzimet e çdo sektori do të jetë 1/5 e njësisë së kontributit të shteteve anëtare. Këto kontribute do të konsiderohen si të ardhura të Unionit. Ato do të bartin interesin në përputhje me dispozitat e nr.474 më sipër.

Shtuar 480A-1998 5 bis) Kur një shtet anëtar kontribon në shlyerjen e shpenzimeve të Unionit, sipas nr.159 të Kushtetutës, duhet të identifikojë sektorin për të cilin jepet ky kontribut.

Hequr 481 deri 483-1998

Shtuar 483A-1998 Pjesëmarrësit e përshkruar në nr.241A të kësaj konvente, do të kontribojnë në pagesat e shpenzimeve të sektorit dhe grupit të studimit dhe nëngrupeve të studimit ku ata marrin pjesë, ashtu siç e përcakton Këshilli.

Ndryshuar 484-1998 5. Këshilli do të përcaktojë kritere për aplikim për mbulimin e kostos për disa produkte dhe shërbime të Unionit.

Ndryshuar 485-1998 6. Unioni do të ketë një llogari rezervë me qëllim që të sigurojë kapitale pune që do t'iu përgjigjen shpenzimeve kryesore dhe do të ruajë rezerva të mjaftueshme *cash* për të mënjanuar, sa më shumë të jetë e mundur, marrjen e huasë. Vlera e llogarive rezerve do të fiksohet çdo vit nga Këshilli duke marrë për bazë kërkesat e parashikuara. Në përfundim të çdo periudhe buxhetore dyvjeçare, të gjitha depozitat bankare të buxhetit që nuk janë shpenzuar apo penguar do t'i kalojnë llogarisë rezervë. Detaje të tjera për këtë llogari përshkruhen në rregulloret financiare.

Ndryshuar 486-1994 7. (1) Sekretari i Përgjithshëm, në marrëveshje me Komitetin Koordinativ, do të pranojë kontributet vullnetare në monedhë ose në natyrë, vetëm nëse kushtet që shoqërojnë të tilla kontribute vullnetare të jenë në përputhje me qëllimin dhe programin e Unionit dhe me programet e aprovuara nga një konferencë dhe të përshtatura me rregulloret financiare, të cilat do të përmbajnë dispozita specifike për pranimin dhe përdorimin e kontributeve të tilla vullnetare.

Ndryshuar 487-1994 5. Kontribute të tilla vullnetare do të raportohen nga Sekretari i Përgjithshëm në Këshill nëpërmjet raportit operues financiar shoqëruar me një përmbledhës që tregon për çdo rast origjinën, propozimin për përdorimin e tyre dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me çdo kontribut vullnetar.

Neni 35
Gjuhët

Ndryshuar 490-1998 1 1) Gjuhët e tjera të ndryshme me ato të përmendura në dispozitat përkatëse të përmendura në nenin 29 të Kushtetutës mund të përdoren:

Ndryshuar 491-1998 a) në qoftë se është bërë një aplikim pranë Sekretarit të Përgjithshëm për të siguruar përdorimin e një ose disa gjuhëve shtesë, gojor ose të shkruajtur, në bazë të përkohshme ose *ad hoc* (për përdorim të veçantë), me kusht që kostoja shtesë e krijuar do të mbulohet nga Shtetet Anëtare që kanë bërë apo mbështetur këtë aplikim.

Ndryshuar 492-1998 b) në qoftë se, në konferencat dhe mbledhjet e Unionit, dhe pas informimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtorit të byrosë përkatëse, ndonjë delegacion siguron me shpenzimet e veta përkthimin gojor të gjuhës së vet në një nga gjuhët referuar në dispozitat përkatëse të nenit 29 të Kushtetutës.

Ndryshuar 493-1998 2) Për rastet e përmendura në nr.491 më sipër, Sekretari i Përgjithshëm do t'i bëjë një shtesë aplikimit, duke siguruar më parë që shtetet anëtare përkatëse marrin përsipër që koston e shkaktuar t'ia ripaguajnë Unionit në kohën e duhur.

Ndryshuar 495-1998 2. Ndonjë nga dokumentet referuar dispozitave përkatëse të nenit 29 të Kushtetutës mund të publikohet në gjuhë tjetër të ndryshme nga ato të specifikuara me të, me kusht që shtetet anëtare që kërkojnë një publikim të tillë të marrin përsipër mbulojnë gjithë koston që përfshin përkthimin dhe publikimin.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË NDRYSHME LIDHUR ME OPERIMIN E SHËRBIMEVE TË TELEKOMUNIKACIONIT

Neni 37
Interpretimi dhe shlyerja e llogarive

Ndryshuar 497-1998 1. Shlyerja e llogarive ndërkombëtare do të konsiderohet si transaksione qarkulluese dhe do të jenë efektive në përputhje me detyrimet ndërkombëtare rrjedhëse të shteteve anëtare dhe të anëtarëve të sektorit përkatës në ato raste kur qeveritë e tyre kanë lidhur marrëveshje për këtë çështje. Atje ku nuk ka marrëveshje të tilla të përfunduara dhe në mungesë të marrëveshjeve specifike, sipas nenit 42 të Kushtetutës, shlyerja e llogarive do të bëhet në përputhje me rregulloret administrative.

Ndryshuar 498-1998 2. Administratat e shteteve anëtare dhe të anëtarëve të sektorit veprimtaria e të cilave lidhet me shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit do të lidhin një marrëveshje lidhur me sasinë e debiteve dhe kredive të tyre.

Neni 38
Njësia monetare

Ndryshuar 500-1998 Në mungesë të marrëveshjeve specifike të përfunduara ndërmjet shteteve anëtare, njësia monetare e përdorur në krijimin e kursit të llogarive për shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit dhe në krijimin e llogarive ndërkombëtare do të jetë:

- njësia monetare e Fondit Monetar Ndërkombëtar,
- ose franga ari,

përcaktuar sipas rregulloreve administrative. Dispozitat për përdorim i përmban shtojca 1 e Rregulloreve Ndërkombëtare të Telekomunikacionit.

Ndryshuar 505-1998 2. Telegramet private në gjuhë sekrete ndërmjet të gjitha shteteve anëtare mund të lejohen me përjashtim të atyre për të cilat ekziston njoftimi paraprak nga Sekretari i Përgjithshëm që të mos lejohet kjo gjuhë për atë kategori korrespondence.

Ndryshuar 506-1998 3. Shtetet anëtare të cilat nuk lejojnë origjinimin ose terminimin në territorin e tyre të telegrameve private në gjuhë sekrete duhet t'i lejojnë ato të kalojnë transit, përveç rasteve të pezullimit të shërbimit sipas nenit 35 të Kushtetutës.

KAPITULLI VI
GJYKIMI DHE AMENDIMI

Neni 41
Gjykimi: Procedura
(shih nenin 56 të Kushtetutës)

Ndryshuar 510-1998 4. Nëse gjykimi i lihet në dorë qeverive ose administratave të tyre, ato duhet të zgjidhen ndërmjet shteteve anëtare, të cilat nuk janë përfshirë në debat, por që janë palë në marrëveshje, zbatimi i së cilës shkakton debate.

Neni 42
Dispozitat për amendimin e kësaj Konvente

Ndryshuar 519-1998 1. Një shtet anëtar mund të propozojë ndonjë ndryshim në këtë konventë. Një propozim i tillë, me qëllim që të sigurojë transmetim të njëkohshëm dhe konsiderata nga të gjitha shtetet anëtare, duhet të arrijë te Sekretari i Përgjithshëm jo më vonë se tetë muaj para ditës së fiksuar për hapjen e konferencës së të plotfuqishmëve. Sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtë muaj para datës më të vonë, Sekretari i Përgjithshëm do t'u drejtojë një propozim të tillë të gjitha shteteve anëtare.

Ndryshuar 520-1998 2. Ndonjë modifikim i propozuar në ndonjë ndryshim, të kërkuar në përputhje me nr.519 më sipër, megjithatë të jetë paraqitur në çdo kohë nga një shtet anëtar ose nga delegacioni i tij në konferencat e të plotfuqishmëve.

Ndryshuar 523-1998 5. Nëse nuk specifikohet ndryshe në paragrafët e mësipërm të këtij neni, të cilat do të jenë të parat që do të merret në konsideratë, do të aplikohen rregullat e përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit.

Ndryshuar 524-1998 6. Ndonjë amendim i kësaj Konvente, aprovuar nga një konferencë e të plotfuqishmëve, do të hyjë në forcë si e tërë ose në formën e instrumentit amendues të vetëm në një datë të fiksuar nga konferenca ndërmjet shteteve anëtare që kanë depozituar para kësaj date instrumentin e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes në forcë të kësaj Konvente dhe instumenteve amenduese. Ratifikimi, pranimi, miratimi apo hyrja në forcë e vetëm një pjese të një instrumenti të tillë amendues përjashtohet.

Ndryshuar 526-1998 8. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet anëtare për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikuar, pranuar, aprovuar apo hyrë në forcë.

SHTOJCË

PËRCAKTIMI I TERMAVE TË CAKTUARA QË PËRDOREN NË KËTË KONVENTË DHE RREGULLORET ADMINISTRATIVE TË BASHKIMIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT

Ndryshuar 1002-1998 Vëzhgues: Një person i dërguar nga:

- Kombet e Bashkuara, një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, një organizatë rajonale e telekomunikacionit ose një organizatë ndërqeveritare që operon me sistemet satelitore, që marrin pjesë, në një kapacitet këshillues, në një konferencë të të plotfuqishmëve, në një konferencë ose në një mbledhje të sektorit;
- një organizatë ndërkombëtare që merr pjesë, në një kapacitet këshillues, në një konferencë ose në një mbledhje të një sektori;
- një qeveri e një shteti anëtar që merr pjesë, në një kapacitet jovotues, në një konferencë rajonale ose
- një anëtar sektori, referuar në nr.229 ose 231 të konventës, ose një organizatë e një karakteri ndërkombëtar që përfaqëson një anëtar sektori të tillë,
- në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj konvente.

Pjesa II-Data e hyrjes në fuqi

Ndryshimet që përmbajnë instrumentet prezente, të marra si një e tërë dhe në formën e një instrumenti të vetëm, do të hyjnë në fuqi në 1 janar 2004 ndërmjet shteteve anëtare që janë, në këtë kohë, palë në Kushtetutën dhe Konventën e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992) dhe që kanë depozituar para kësaj date instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi të instrumentit aktual të ndryshuar.

INSTRUMENTI QË AMENDON KUSHTETUTËN E BASHKIMIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT (GJENEVË, 1992)

Miratuar nga Konferenca e të Plotfuqishmëve (Kyoto, 1994), Konferenca e të Plotfuqishmëve në (Minneapolis, 1998) dhe nga Konferenca e të Plotfuqishmëve (Marrakesh 2002)

HYRJE

Për arsye dhe në zbatim të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë, 1992), në veçanti atyre të nenit 55, Konferenca e të Plotfuqishmëve (Kyoto 1994), Konferenca e të Plotfuqishmëve (Minneapolis 1998) dhe Konferenca e të Plotfuqishmëve (Marrakesh 2002) kanë aprovuar amendimet e mëposhtme të Kushtetutës.

KAPITULLI I

DISPOZITA BAZË

Neni 1
Qëllimet e Unionit

Ndryshuar 3-1998 a) të ruajë dhe të zgjerojë kooperimin ndërkombëtar midis të gjitha shteteve anëtare të Unionit për sigurimin dhe përdorimin racional të telekomunikacioneve të të gjitha llojeve.

Shtuar 3A- 1998 abis) të nxisë dhe të rrisë pjesëmarrjen e enteve dhe organizatave në aktivitetet e Unionit, si dhe të nxisë kooperimin e frutshëm dhe partneritetin përmes tyre dhe shteteve anëtare për përmbushjen e të gjitha objektivave të përfshira në qëllimet e Unionit.

Ndryshuar 4- 1998 b) të nxisë dhe të ofrojë asistencë teknike për vendet në zhvillim në fushën e telekomunikacionit dhe të përkrahë, gjithashtu, mobilizimin e burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e saj, si dhe të aksesit në informacion.

Ndryshuar 8-1998 f) të harmonizojë veprimtarinë e shteteve anëtare dhe të nxisë kooperimin e frutshëm dhe konstruktiv dhe partneritetin përmes shteteve anëtare dhe anëtarëve të sektorit në arritjen e këtyre përfundimeve.

Ndryshuar 11-1998 a) të mundësojë përcaktimin efektiv të brezave të spektrit të radio-frekuencave, përcaktimin e kanaleve të frekuencave sipas një plani të aprovuar nga konferencat kompetente dhe regjistrimin e radiofrekuencave të dhëna dhe, për shërbimet hapësinore, të ndonjë pozicioni orbital shoqërues në orbitat satelitore gjeostacionare ose të ndonjë karakteristike shoqëruese të sateliteve në orbitat e tjera, me qëllim që të pengohen interferencat e dëmshme përmes stacioneve radio të vendeve të ndryshme.

Ndryshuar 12-1998 b) të koordinojë përpjekjet për të eliminuar interferencat e dëmshme përmes stacioneve radio të vendeve të ndryshme dhe për të siguruar përdorimin e spektrit të radiofrekuencave për shërbimet e radiokomunikacionit, të satelitëve gjeostacionarë dhe orbitat e tjera satelitore.

Ndryshuar 14-1998 d) të inkurajojë kooperimin dhe solidaritetin ndërkombëtar për ofrimin e asistencës teknike në vendet në zhvillim dhe krijimin, zhvillimin dhe sigurimin, në të gjithë kuptimin e saj, të pajisjeve të telekomunikacionit dhe rrjeteve në vendet në zhvillim, duke përfshirë pjesëmarrjen e saj në programet përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe, nëse duhet, përdorimin e vetë burimeve të saj.

Ndryshuar 16- 1998 f) të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare dhe anëtareve të sektorit me idenë e krijimit të klasave me nivel sa më të ulët të jetë e mundur për sigurimin e një shërbimi efiçent duke marrë në konsideratë nevojat për ruajtjen e admnistrimit financiar të pavarur të telekomunikacioneve me bazë zërin.

Ndryshuar 19A-1998 j) të nxisë pjesëmarrjen e enteve të interesuara në aktivitetet e Unionit dhe kooperimin me organizatat rajonale dhe organizatat e tjera për plotësimin e qëllimeve të Unionit.

Neni 2
Përbërja e Unionit

Ndryshuar 20-1998 Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve është një organizatë ndërqeveritare në të cilën shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit, duke pasur shumë mirë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e tyre, kooperojnë për plotësimin e qëllimeve të Unionit. Duke pasur parasysh parimet e universalitetit dhe të dëshirës për pjesëmarrje universale në Union, ai të ketë përbërjen e mëposhtme:

Ndryshuar 21-1998 a) çdo shtet i cili është shtet anëtar i Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit si palë në një konventë të telekomunikacionit ndërkombëtar, para se të hynte në fuqi kjo Kushtetutë dhe konventa;

Ndryshuar 23-1998 c) çdo shtet tjetër, joanëtar i Kombeve të Bashkuara, që kërkon të anëtarësohet në Union dhe që, pasi ka siguruar miratimin e një kërkese të tillë nga dy të tretat e shteteve anëtare të Unionit, pranon këtë Kushtetutë dhe konventën, në përputhje me nenin 53 të kësaj Kushtetute. Nëse një kërkesë e tillë për anëtarësim është bërë gjatë intervalit ndërmjet dy konferencave të të plotfuqishmëve, Sekretari i Përgjithshëm do të konsultohet me shtetet anëtare të Unionit; një shtet anëtar do të konsiderohet se ka abstenuar nëse nuk përgjigjet brenda katër muajve nga dita kur është kërkuar opinioni i tij.

Neni 3
Ndryshuar **Të drejtat dhe detyrimet e shteteve anëtare dhe anëtarëve të sektorit**

Ndryshuar 24-1998 1. Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit do të kenë të drejtat dhe do të jenë subjekt i detyrimeve të paraqitura në këtë Kushtetutë dhe në konventë.

Ndryshuar 25-1998 2. Të drejtat e shteteve anëtare që lidhen me pjesëmarrjen e tyre në

konferenca, mbledhje dhe konsultime të Unionit janë:

Ndryshuar 26-1998 a) të gjitha shtetet anëtare do të kenë të drejtë të marrin pjesë në konferenca, të zgjidhen në Këshill dhe do të kenë të drejtë të emërojnë kandidatë për t'u zgjedhur si zyrtarë të Unionit ose si anëtarë të Bordit të Rregulloreve Radio;

Ndryshuar 27-1998 b) në zbatim të dispozitave të nr.169 dhe 210 të kësaj Kushtetute, çdo shtet anëtar i këshillit do të ketë një votë në të gjitha konferencat e të plotfuqishmëve, në të gjitha konferencat botërore dhe të gjitha asambletë e sektorit dhe mbledhjet e grupeve të studimit dhe, në qoftë se është shtet anëtar i Këshillit, në të gjitha sesionet e Këshillit. Në konferencat rajonale, vetëm shtetet anëtare të rajonit përkatës do të kenë të drejtë të votojnë;

Ndryshuar 28-1998 c) në zbatim të dispozitave të nr.169 dhe 210 të kësaj Kushtetute, çdo shtet anëtar do të ketë, gjithashtu, një votë në të gjitha konsultimet e kryera nëpërmjet korrespodencës. Në rastin e konsultimeve lidhur me konferencat rajonale, vetëm shtetet anëtare të rajonit përkatës do të kenë të drejtë të votojnë.

Shtuar 28A-1998 3. Në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e Unionit, anëtarëve të sektorit do t'u jepet e drejta të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e sektorit në të cilën ata janë anëtare, duke respektuar dispozitat përkatëse të kësaj Kushtetute dhe konventës:

Shtuar 28B- 1998 a) ata kanë të drejtën të zgjedhin kryetarë ose nënkryetarë të asambleve dhe mbledhjeve të sektorit dhe konferencave botërore të zhvillimit të telekomunikacionit;

Shtuar 28C-1998 b) atyre do t'u jepet e drejta, në zbatim të dispozitave të Konventës dhe vendimeve përkatëse të aprovuara në këtë rast nga konferenca e të plotfuqishmëve, të marrin pjesë në miratimin e çështjeve, rekomandimeve dhe vendimeve që lidhen me metodat e punës dhe procedurat e sektorit ku janë anëtarë.

Neni 4
Instrumentet e Unionit

Ndryshuar 31- 1998 3. Dispozitat e kësaj Kushtetute dhe të konventës janë të plotësuara me ato të rregullores administrative, të renditura më poshtë, të cilat rregullojnë përdorimin e telekomunikacioneve dhe do të jenë detyruese për të gjitha shtetet anëtare:

- Rregulloret ndërkombëtare të telekomunikacionit,
- Rregulloret radio.

Neni 6
Zbatimi i instrumenteve të Unionit

Ndryshuar 37-1998 1. Shtetet anëtare janë të detyruara të respektojnë dispozitat e kësaj Kushtetute, konventës dhe rregulloreve admnistrative në të gjitha zyrat dhe stacionet e telekomunikacionit, të instaluara ose përdorura prej tyre, që janë pjesë e shërbimeve ndërkombëtare ose që mund të shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimet radio të vendeve të tjera, duke mos përfshirë rastet e shërbimeve që janë të përjashtuar nga këto detyrime, në përputhje me dispozitat e nenit 48 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 38-1998 2. Shtetet anëtare janë, gjithashtu, të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të imponuar zbatimin e dispozitave të kësaj Kushtetute, konventës dhe rregulloreve administrative nga agjencitë operuese, të autorizuar nga ata të sigurojnë dhe përdorin telekomunikacione që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve ndërkombëtare ose që përdorin stacione që mund të shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimet radio të vendeve të tjera.

Neni 7
Struktura e Unionit

Ndryshuar 44-1998 e) Sektori i standardizimit të telekomunikacionit, duke përfshirë asambletë botërore të standardizimit të telekomunikacionit.

Neni 8
Konferenca e të Plotfuqishmëve

Ndryshuar 47-1998 1. Konferenca e të plotfuqishmëve do të ketë delegatë që përfaqësojnë shtetet

anëtare. Ajo do të mblidhet çdo katër vjet.

Ndryshuar 48-1998 2. Në bazë të propozimeve nga shtetet anëtare dhe duke marrë në konsideratë raportet e Këshillit, Konferenca e të plotfuqishmëve:

Ndryshuar 50-1998 b) do të marrë në konsideratë raportet e hartuara nga Këshilli, që nga konferenca e mëparshme e të plotfuqishmëve, lidhur me aktivitetet e Unionit, si dhe raportet për politikën dhe planifikimin strategjik të Unionit;

Ndryshuar 51-2002 c) bazuar në vendimet e saj të marra në raportet, që i referohen nr.50 më sipër, do të krijojë planin strategjik për Unionin dhe bazat për hartimin e buxhetit të Unionit, dhe do të përcaktojë kufijtë financiaëe përkatës, deri në konferencën tjetër të të plotfuqishmëve, mbasi të jenë marrë në konsideratë të gjitha aspektet që i përkasin veprimtarisë së Unionit në këtë periudhë;

Ndryshuar 51A-1998 d) do të përcaktojë, duke përdorur procedurat e përshkruara në nr.161D deri në 161G të kësaj Kushtetute, numrin total të njësive të kontributit për periudhën deri në konferencën e ardhshme të të plotfuqishmëve në bazë të klasave të kontributit që shtetet anëtare kanë deklaruar;

Ndryshuar 54- 1998 f) do të zgjedhë shtetet anëtare të cilat do të punojnë për Këshillin;

Ndryshuar 57-1998 i) do të marrë në konsideratë dhe miratojë, nëse është e nevojshme, propozimet e parashtruara nga shtetet anëtare, për ndryshimet e kësaj Kushtetute dhe të konventës, respektivisht në përputhje me dispozitat e nenit 55 të kësaj Kushtetute dhe dispozitave përkatëse të Konventës.

Ndryshuar 58A- 2002 j bis) aprovon dhe amendon rregulloret e përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit.

Shtuar 59A-1994 3. Në raste të veçanta, në intervalin midis dy konferencave të të plotfuqishmëve të radhës, mund të organizohet një konferencë e të plotfuqishmëve e jashtëzakonshme me një axhentë të kufizuar që trajton çështje specifike:

Shtuar 59B- 1994 a) me një vendim të Konferencës së të Plotfuqishmëve të fundit të radhës;

Shtuar 59C- 1998 b) nëse dy të tretat e anëtarëve të Unionit e kanë kërkuar atë individualisht pranë Sekretarit të Përgjithshëm;

Shtuar 59D-1998 c) me propozim të Këshillit dhe miratimin nga të paktën dy të tretat e anëtarëve të Unionit.

Neni 9

Parimet lidhur me zgjedhjet dhe çështjet që lidhen me të

(Ndryshuar) 61-2002 a) Shtetet anëtare të këshillit zgjidhen bazuar në parimin e një shpërndarjeje të barabartë të vendeve në Këshill, me qëllim përfaqësimin e të gjitha rajoneve të botës.

Ndryshuar 62- 2002 b) Sekretari i Përgjithshëm, zëvendëssekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e byrosë do të zgjidhen përmes kandidaturave që shtetet anëtare propozojnë nga vendet e tyre dhe që duhet të jenë të gjitha me kombësi nga shtete të ndryshme anëtare, dhe në zgjedhjen e duhur të tyre duhet të merret në konsideratë shpërndarja e barabartë gjeografike përmes rajoneve të botës; vëmendja e duhur duhet, gjithashtu t'u kushtohet principeve të shprehura në nr.154 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 63- 2002 c) Anëtarët e Bordit të rregulloreve radio do të zgjidhen bazuar në aftësitë e tyre individuale, përmes kandidaturave që shtetet anëtare propozojnë nga vendet e tyre. Çdo shtet anëtar mund të propozojë vetëm një kandidat. Anëtarët e Bordit të Rregullores Radio nuk duhet të kenë kombësi të njëjtë me drejtorin e Byrosë së Radiokomunikacionit; në zgjedhjen e tyre vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shpërndarjes së barabartë gjeografike përmes rajoneve të botës dhe parimeve të shprehura në nr.93 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 64-2002 2. Dispozitat që lidhen me detyrat, vendet e lira dhe rizgjedhjen përshkruhen në konventë.

Neni 10

Këshilli

Ndryshuar 65-1998 1 1) Këshilli do të përbëhet nga shtetet anëtare të zgjedhur nga konferenca e të plotfuqishmëve, në përputhje me dispozitat e nr.61 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 66- 2002 2) Çdo shtet anëtar i Këshillit do të caktojë një person, të ndihmuar nga një ose më shumë këshilltar, i cili do të punojë në Këshill.

Fshirë* 67- 2002

Ndryshuar 69- 1998 4. Këshilli do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin

nga shtetet anëtare të dispozitave të kësaj Kushtetute, të konventës, të rregulloreve administrative, të vendimeve të konferencës së të plotfuqishmëve dhe, kur është e nevojshme, të vendimeve të konferencave dhe mbledhjeve të tjera të Unionit, dhe kryen ndonjë detyrë të caktuar për të nga konferenca e të plofuqishmëve.

Ndryshuar 70-2002 2) Këshilli do të vlerësojë në një aspekt të gjerë politikën e telekomunikacionit të nxjerrë në përputhje me udhëzimet e dhëna në konferencën e të plotfuqishmëve për të siguruar që politikat dhe strategjia e Unionit t'i përgjigjen plotësisht ndryshimeve në telekomunikacione.

Shtuar 70A–2002 2 bis) Këshilli do të përgatisë një raport për politikën dhe planin strategjik rekomanduar për Unionit, së bashku me termat financiare, duke përdorur të dhënat specifike të përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm në zbatim të nr.74A më poshtë.

Neni 11
Sekretariati i përgjithshëm

Shtuar 73A-1998 2) Funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm janë specifikuar në konventë. Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm:

Ndryshuar 74-1998 a) do të koordinojë, me ndihmën e Komitetit Koordinativ, aktivitetet e Unionit;

Ndryshuar 74A-2002 b) do të përgatisë, me ndihmën e Komitetit Koordinativ, dhe do t'u sigurojë shteteve anëtarë dhe anëtarëve të sektorit, informacione të tilla specifike që mund të nevojiten për përgatitjen e një raporti për politikat dhe planin strategjik të Unionit dhe për koordinimin dhe zbatimin e planit; ky raport do t'u komunikohet për rishikim shteteve anëtare dhe anëtareve të sektorit gjatë dy sesioneve të fundit të zakonshme të Këshillit para një konferencë të të plotfuqishmëve;

Ndryshuar 75-1998 c) do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përdorimin ekonomik të burimeve të Unionit dhe të jetë përgjegjës në Këshill për të gjitha aspektet administrative dhe financiare të aktiviteteve të Unionit;

Ndryshuar 76 -1998 d) do të veprojë si përfaqësues ligjor i Unionit.

Shtuar 76A-1998 3) Sekretari i Përgjithshëm do t'i depozitojë marrëveshjet specifike të hartuara në përputhje me nenin 42 të kësaj Kushtetute.

KAPITULLI II
SEKTORI I RADIOKOMUNIKACIONIT

Neni 12
Funksionet dhe strukturat

Ndryshuar 78 1- 1998 1) Funksionet e sektorit të radiokomunikacionit, duke marrë parasysh interesat specifike të vendeve në zhvillim, do t'i shërbejnë përmbushjes së qëllimeve të Unionit, siç përshkruhet në nenin 1 të kësaj Kushtetute, lidhur me radiokomunikacionin:

- nëpërmjet sigurimit të përdorimit racional, të barabartë, efikas dhe ekonomik të spektrit të radiofrekuencave nga të gjitha shërbimet e radiokomunikacionit, duke përfshirë ato që përdorin satelitët gjeostacionarë ose orbitat e tjera satelitore, në zbatim të dispozitave të nenit 44 të kësaj Kushtetute; dhe
- nëpërmjët kryerjes së studimeve, pa kufizim në diapazonin e frekuencave, dhe miratimit të rekomandimeve për çështje të radiokomunikacionit.

Ndryshuar 83- 1998 c) asambleve të radiokomunikacionit;

Shtuar 84A- 1998 d bis) grupet këshilluese të radiokomunikacionit;

Ndryshuar 87 - 1998 c) administratave të të gjitha shteteve anëtare, si e drejtë e tyre;

Ndryshuar 88-1998 b) ndonjë ent ose organizatë që bëhet anëtar sektori në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kushtetute.

Neni 13
Konferencat e radiokomunikacionit dhe asambletë e radiokomunikacionit

Ndryshuar 90-1998 2. Konferencat botërore të radiokomunikacionit do të mblidhen normalisht çdo dy-tre vjet; megjithatë, në ndjekje të zbatimit të dispozitave përkatëse të konventës, një konferencë e tillë mund të mos organizohet ose mund të konsiderohet i nevojshëm organizimi edhe i një konference shtesë.

Ndryshuar 91-1998 3. Asambletë e radiokomunikacionit do të mblidhen normalisht çdo dy-tre

vjet, dhe mund të zhvillohen në të njëjtin vend dhe kohë me konferencat botërore të radiokomunikacionit për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin e sektorit të radiokomunikacionit. Asambletë e radiokomunikacionit do të sigurojnë bazat e nevojshme teknike për punën e konferencave botërore të radiokomunikacionit dhe do t'u përgjigjen të gjitha kërkesave të konferencave botërore të radiokomunikacionit. Detyrat e asambleve të radiokomunikacionit janë specifikuar në konventë.

Ndryshuar 92-1998 4. Vendimet e konferencës botërore të radiokomunikacionit, të një asambleje të radiokomunikacionit dhe të një konference rajonale të radiokomunikacionit do të jenë në të gjitha rastet në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me konventën. Vendimet e një asambleje të radiokomunikacionit të një konference rajonale të radiokomunikacionit do të jenë, gjithashtu, në të gjitha rrethanat në pajtim me rregulloret radio. Kur konferencat aprovojnë rezoluta dhe vendime, do të merren në konsideratë termat e parashikueshëm financiarë dhe do të pengohet adoptimi i rezolutave dhe vendimeve, të cilat mund të japin rritje të shpenzimeve mbi kufijtë financiarë të vendosura nga konferenca e të plotfuqishmëve.

Neni 14
Bordi i Rregullores Radio

Shtuar 93A-1998 2. Bordi i Rregullores Radio është i përbërë nga jo më shumë se 12 anëtarë ose nga një numër që i korrespondon 6% të numrit total të shteteve anëtare, sado i madh të jetë ky numër.

Ndryshuar 95- 2002 a) Miratimi i rregullave procedurale, të cilat përfshijnë kriteret teknike, në përputhje me rregulloret radio dhe me ndonjë vendim, i cili mund të jetë marrë nga konferencat kompetente të radiokomunikacionit. Këto rregulla procedurale do të përdoren nga drejtori dhe Byroja në zbatimin e rregulloreve radio për regjistrimin e frekuencave të dhëna për përdorim nga shtetet anëtare. Këto rregulla do të trajtohen në mënyrë transparente dhe do të jenë të hapura për komente nga administratat dhe, në raste të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme, problemi do të paraqitet për diskutim në konferencën tjetër të të plotfuqishmëve;

Ndryshuar 97-1998 c) Kryerja e ndonjë detyre shtesë, lidhur me caktimin dhe përdorimin e frekuencave, siç sqarohet në nr.78 të kësaj Kushtetute, në përputhje me procedurat e përcaktuara për të në rregulloret radio, dhe siç përshkruhet nga një konferencë kompetente ose nga Këshilli me miratimin e shumicës së shteteve anëtare, në përgatitjen për, ose në zbatim të vendimeve të një konference të tillë.

Ndryshuar 99-1998 2) Asnjë anëtar Bordi nuk do të kërkojë ose marrë instruksione, lidhur me ushtrimin e detyrave të tij për Unionin, nga ndonjë qeveri ose anëtar, nga ndonjë organizatë publike apo private dhe as nga ndonjë person. Anëtarët e Bordit do të jenë të kujdesshëm në kryerjen e ndonjë veprimi ose në marrjen e ndonjë vendimi, i cili mund të jetë i papajtueshëm me statusin e tyre, përcaktuar në nr.98 më sipër.

Ndryshuar 100-1998 3) Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit do të respektojnë karakterin ndërkombëtar ekskluziv të detyrave të anëtarëve të Bordit dhe do të kufizohen nga përpjekjet për ndikim tek ata për zbatimin e detyrave të Bordit.

Neni 15
Ndryshuar
Grupet e studimit të radiokomunikacionit dhe grupi këshillues

Ndryshuar 102-1998 Detyrat respektive të grupeve të studimit dhe të grupit këshillues janë specifikuar në konventë.

KAPITULLI III
SEKTORI I STANDARDIZIMIT TË TELEKOMUNIKACIONIT

Neni 17
Funksionet dhe strukturat

Ndryshuar 104-1998 1. 1) Funksionet e sektorit të standardizimit të telekomunikacionit, duke marrë parasysh interesat specifike të vendeve në zhvillim, do t'i shërbejnë përmbushjes së qëllimeve të Unionit lidhur me standardizimin e telekomunikacionit, siç shprehet në nenin 1 të kësaj Kushtetute, nëpërmjet studimeve të çështjeve teknike, vepruese e atyre të lidhura me tarifat dhe miratimit të rekomandimeve për to me vizionin e standardizimit të telekomunikacioneve në bazë mbarëbotëror.

Ndryshuar 107- 1998 a) Asambleve botërore të standardizimit të telekomunikacionit;

Ndryshuar 108A- 1998 b bis) grupit këshillues i standardizimit të telekomunikacionit;

Ndryshuar 111- 1998 a) administratave të të gjitha shteteve anëtare, si e drejtë e tyre;

Ndryshuar 112-1998 b) ndonjë enti ose organizatë që bëhet anëtar sektori në përputhje me dispozitat përkatëse të konventës.

Neni 18

Ndryshuar **Asambletë botërore të standardizimit të telekomunikacionit**

Ndryshuar 113-1998 1. Detyrat e asambleve botërore të standardizimit të telekomunikacionit janë të specifikuara në konventë.

Ndryshuar 114-1998 2. Asambletë botërore të standardizimit të telekomunikacionit do të mblidhen çdo katër vjet; megjithatë, një asamble tjetër plotësuese mund të organizohet në përputhje me dispozitat e kësaj konvente.

Ndryshuar 115-1998 3. Vendimet e asambleve botërore të standardizimit të telekomunikacionit duhet të jenë në të gjitha rrethanat në përputhje me këtë Kushtetutë, konventën dhe rregulloret administrative. Kur aprovohen rezoluta dhe vendime, asambletë do të marrin në konsideratë termat e parashikueshme financiare dhe do të eliminojnë miratime të rezolutave dhe vendimeve, të cilat mund të sjellin rritjen e shpenzimeve mbi kufijtë financiarë të vendosura nga konferenca e të plotfuqishmëve.

Neni 19

Grupet e studimit të standardizimit të telekomunikacioneve dhe grupi këshillues

Ndryshuar 116-1998 Detyrat respektive të grupeve të studimit të standardizimit të telekomunikacionit dhe grupit këshillues janë specifikuar në konventë.

KAPITULLI IV

SEKTORI I ZHVILLIMIT TË TELEKOMUNIKACIONIT

Neni 21

Funksionet dhe strukturat

Ndryshuar 122-1998 b) Të nxisë, veçanërisht në kuptimin e partneritetit, zhvillimin, zgjerimin dhe operimin e rrjeteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit, në mënyrë të veçantë në vendet në zhvillim, duke marrë në konsideratë aktivitetet e koorporatave të tjera, nëpërmjet krijimit të mundësive të reja të zhvillimit të burimeve njerëzore, planifikimit, menaxhimit, mobilizimit të burimeve, si dhe punëve kërkimore;

Shtuar 132A- 1998 b bis) grupit këshillues të zhvillimit të telekomunikacionit;

Ndryshuar 135-1998 a) administratave të të gjitha shteteve anëtare, si e drejtë e tyre;

Ndryshuar 136-1998 b) ndonjë enti ose organizatë që bëhet anëtare sektori në përputhje me dispozitat përkatëse të konventës.

Neni 22

Konferencat e zhvillimit të telekomunikacionit

Ndryshuar 142-1998 4. Konferencat e zhvillimit të telekomunikacionit nuk do të nxjerrin akte finale. Konkluzionet e tyre do të merren në formën e rezolutave, vendimeve, rekomandimeve ose raporteve. Këto konkluzione duhet, në të gjitha rrethanat, të jenë në konformitet me këtë Kushtetutë, konventën dhe rregulloret administrative. Kur konferencat aprovojnë rezoluta dhe vendime, ato do të marrin në konsideratë termat e parashikueshëm financiarë dhe do të eliminojnë miratimin e rezolutave dhe vendimeve, të cilat mund të shkaktojnë rritjen e shpenzimeve mbi kufijtë financiarë të përcaktuara nga konferencat e të plotfuqishmëve.

Neni 23

Ndryshuar **Grupet e studimit të standardizimit**
të telekomunikacioneve dhe grupi këshillues

Ndryshuar 144-1998 Detyrat respektive të grupeve të studimit të standardizimit të telekomunikacionit dhe grupit këshillues janë specifikuar në konventë.

Shtuar KAPITULLI IV A
Shtuar METODAT E PUNËS SË SEKTORËVE

Shtuar 145A-2002 Asambleja e radiokomunikacionit, asambleja botërore e standardizimeve në telekomunikacion dhe konferenca botërore e zhvillimit të telekomunikacioneve mund të përcaktojnë dhe ndryshojnë metodat e punës dhe procedurat për menaxhimin e aktiviteteve të sektorëve të tyre respektive. Këto metoda pune dhe procedura duhet të jenë konform kësaj Kushtetute, konventës dhe rregulloreve administrative, dhe në veçanti nr.246 D deri në nr.246 H të konventës.

KAPITULLI V
KËRKESA TË TJERA LIDHUR ME FUNKSIONIMIN E UNIONIT

Neni 25
Konferencat botërore të telekomunikacionit ndërkombëtar

Ndryshuar 147-1998 2. Vendimet e konferencave botërore të telekomunikacionit ndërkombëtar do të jenë në të gjitha rrethanat në konformitet me këtë Kushtetutë dhe konventë. Kur konferencat aprovojnë rezoluta dhe vendime do të marrin në konsideratë termat e parashikueshëm financiarë dhe do të eliminojnë miratimin e atyre rezolutave apo vendimeve, të cilat shkaktojnë rritje të shpenzimeve sipër kufijve financiarë të përcaktuar nga konferenca e të plotfuqishmëve.

Neni 27
Zyrtarët e zgjedhur dhe stafi i Unionit

Ndryshuar 151- 1998 2) Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit do të respektojnë karakterin ndërkombëtar ekskluziv të detyrave të zyrtarëve të zgjedhur dhe të stafit të Unionit dhe do të kujdesen për ruajtjen e tyre nga përpjekjet për influencë në zbatimin e detyrave të tyre.

Ndryshuar 153- 1998 4) Me qëllim që të sigurohet një veprimtari efikase e Unionit, shteti anëtar, një shtetas i të cilit është zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm, nënsekretar i përgjithshëm ose drejtor i Byrosë, duhet të shmangë, për sa të jetë e mundur, pezullimin e këtij shtetasi përmes dy konferencave të të plotfuqishmëve.

Neni 28
Financat e Unionit

Ndryshuar 159- 1998 2. Shpenzimet e Unionit do të mbulohen nga:

Shtuar 159A- 1998 a) kontributet e shteteve anëtare dhe anëtarëve të sektorit;

Shtuar 159B- 1998 b) të ardhura të tjera të identifikuara në konventë ose në rregulloret financiare;

Shtuar 159C- 1998 2 bis) Çdo shtet anëtar dhe anëtar sektori do të paguajë një shumë ekuivalente me numrin e njësive në klasën e kontributit të zgjedhur në përputhje me nr.160 deri në 161I më poshtë;

Ndryshuar 159D- 2002 2 ter) Shpenzimet e konferencave rajonale në bazë të nr.43 të kësaj Kushtetute do të mbulohen:

Shtuar 159E- 2002 a) nga të gjitha shtetet anëtare të rajonit përkatës, në përputhje me klasën e tyre të kontributit;

Shtuar 159F-2002 b) nga çdo shtet anëtar i ndonjë rajoni tjetër që ka marrë pjesë në këtë konferencë, në përputhje me klasën e tij të kontributit;

Shtuar 159G- 2002 c) nga anëtarë sektori të autorizuar dhe organizata të tjera të autorizuara, të cilët kanë marrë pjesë në një konferencë të tillë, në përputhje me dispozitat e konventës.

Shtuar 160- 1998 3 1) Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit do të jenë të lirë të zgjedhin klasën e tyre të kontributit për të paguar shpenzimet e Unionit.

Shtuar 161-1998 2) Zgjedhja nga shtetet anëtare do të bëhet në konferencat e të plotfuqishmëve në përputhje me shkallën e klasave të kontributit dhe kushtet që përmban konventa dhe me procedurat e përshkruara më poshtë.

Shtuar 161A- 1998 2 bis) Zgjedhja nga anëtarët e sektorit do të bëhet në përputhje me shkallën e

klasave të kontributeve, me kushtet që përmban konventa dhe me procedurat e përshkruara më poshtë.

Shtuar 161B- 1998 3 bis 1) Në sesionin e saj që paraprin konferencën e të plotfuqishmëve, Këshilli do të fiksojë vlerën provizore të njësisë së kontributit në bazë të draftplanit financiar për periudhën korresponduese dhe të numrit total të njësisë së kontributit.

Shtuar 161C-1998 2) Sekretari i Përgjithshëm do të informojë shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit për vlerën provizore të njësisë së kontributit, siç përcaktohët në nr.161B më sipër, dhe fton shtetet anëtare të njoftojnë, jo më vonë se një javë para datës së caktuar për hapjen e konferencës së të plotfuqishmëve, klasën e kontributit që ata kanë zgjedhur provizorisht.

Shtuar 161D-1998 3) Gjatë javës së parë të saj, konferenca e të plotfuqishmëve do të përcaktojë kufirin e sipërm provizor të vlerës së njësisë së kontributit, bazuar në rezultatet e nxjerra nga Sekretari i Përgjithshëm, në zbatim të nr.161B dhe 161C më sipër, dhe duke marrë parasysh ndonjë ndryshim në klasën e kontributit që shtetet anëtare i kanë deklaruar Sekretarit të Përgjithshëm, gjithashtu dhe klasat e kontributit që mbeten të pandryshuara.

Shtuar 161E-1998 4) Duke marrë parasysh draftplanin financiar të rishikuar, konferenca e të plotfuqishmëve do të përcaktojë kufirin përfundimtar të sipërm të vlerës së njësisë së kontributit. Atëherë, Sekretari i Përgjithshëm do t'i ftojë shtetet anëtare të njoftojnë, përpara përfundimit të javës së parafundit të konferencës së të plotfuqishmëve, zgjedhjet e tyre përfundimtare të klasës së kontributit.

Shtuar 161F-2002 5) Shtetet anëtare, të cilat nuk kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për vendimin e tyre, brenda datës së vendosur nga konferenca e të plotfuqishmëve, do të mbeten në klasën e mëparshme të kontributit.

Shtuar 161G-1998 6) Konferenca e të plotfuqishmëve do të aprovojë, më pas, planin financiar përfundimtar në bazë të numrit total të njësivë të kontributit që iu korrespondojnë klasave përfundimtare të kontributit të zgjedhur nga shtetet anëtare në datën në të cilën aprovohet plani financiar.

Shtuar 161H-1998 3 ter 1) Sekretari i Përgjithshëm do t'i informojë anëtarët e sektorit mbi kufirin e sipërm përfundimtar të vlerës së njësisë së kontributit dhe fton ata të njoftojnë, brenda tre muajve nga data e mbylljes së konferencës së të plotfuqishmëve, klasën e kontributit që ata kanë zgjedhur.

Shtuar 161I-1998 2) Anëtarët e sektorit që nuk kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për vendimin e tyre, brenda kësaj periudhe tremujore, do të mbeten në klasën e mëparshme të kontributit.

Ndryshuar 162-1998 3) Ndryshime të shkallës së klasave të kontributit, aprovuar nga një konferencë e të plotfuqishmëve, do të kërkohen për seleksionim të klasës së kontributit gjatë konferencave të ardhshme të të plotfuqishmëve.

Ndryshuar 163-1998 4) Klasa e kontributit zgjedhur nga një shtet anëtar apo anëtar sektori është e aplikueshme që në buxhetin e parë dyvjeçar pas një konference të të plotfuqishmëve.

Hequr 164-1998

Ndryshuar 165-1998 5. Pasi ka zgjedhur klasën e vet të kontributit, një shtet anëtar nuk duhet ta reduktojë atë më shumë se dy klasa kontributi dhe Këshilli do të tregojë mënyrat me të cilat reduktimi do të mund të zbatohet gradualisht në periudhën midis dy konferencave të të plotfuqishmëve. Megjithatë, në rrethana të veçanta të tilla si fatkeqësi natyrore që kërkojnë programe ndihme ndërkombëtare, konferenca e të plotfuqishmëve mund të autorizojë një reduktim më të madh në numrin e njësive të kontributit të shteti anëtar, kur ai këmbëngul se nuk mund të përballojë më gjatë kontributin e klasës fillestare të zgjedhur prej tij.

Shtuar 165 bis-1998 5 bis. Në rrethana të veçanta siç janë fatkeqësitë natyrore që kërkojnë programe ndihme ndërkombëtare, Këshilli mund të autorizojë një reduktim në numrin e njësive të kontributit të shtetit anëtar, kur ai këmbëngul se nuk mund të përballojë më gjatë kontributin e klasës fillestare të zgjedhur prej tij.

Shtuar 165A-1998 5 ter Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit mund të zgjedhin në çdo kohë një klasë kontributi më të lartë se ajo që është miratuar prej tyre.

Hequr 166 dhe 167- 1998

Ndryshuar 168-1998 8. Shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit do të parapaguajnë kontributet e tyre të përbashkëta vjetore, të llogaritura në bazë të buxhetit dyvjeçar, të aprovuar nga Këshilli, si dhe të ndonjë rregullimi të miratuar nga Këshilli.

Ndryshuar 169-1998 9. Një shtet anëtar i cili është i vonuar në pagesat e tij për Unionin do të humbasë të drejtën e votës, siç përcaktohet në nr.27 dhe 28 të kësaj Kushtetute, për sa kohë vlera e papaguar barazohet ose kalon vlerën e kontributit që i takon dy viteve të mëparshme.

Ndryshuar 170-1998 10. Dispozita specifike për kontributet financiare nga anëtarët e sektorit dhe organizatat ndërkombëtare gjenden në konventë.

Neni 31

Kapaciteti ligjor i Unionit

Ndryshuar 176-1998 Unioni gëzon, në territorin e çdo shteti anëtar, kapacitete të tilla ligjore të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tij dhe për përmbushjen e qëllimeve të tij.

Neni 32

Ndryshuar

Rregulla të përgjithshme për konferencat, asambletë dhe mbledhjet e Unionit

Ndryshuar 177-2002 1. Rregullat e përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit të aprovuara nga konferencat e të plotfuqishmëve do të aplikohen në përgatitjen e konferencave dhe asambleve, në organizimin e punëve dhe mënyrat e diskutimit në konferenca, asamble dhe mbledhje të Unionit, gjithashtu në zgjedhjet e shteteve anëtarë në Këshill të Sekretarit të Përgjithshëm, të zëvendëssekretarit të Përgjithshëm, të drejtorit të Byrosë së Sektorëve dhe të anëtarëve të Bordit të Rregulloreve Radio.

Ndryshuar 178-2002 2. Konferencat, asambletë dhe Këshilli mund të aprovojnë të tilla rregulla, kur i konsiderojnë thelbësore për të plotësuar rregullat e përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit, të paraqitura në kapitullin II. Megjithatë, rregulla të tilla plotësuese duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, konventën dhe kapitullin II të lartpërmendur; rregullat e aprovuara nga konferencat ose asambletë do të publikohen si dokumente të konferencës ose të asamblesë përkatëse.

KAPITULLI VI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME TELEKOMUNIKACIONET

Neni 33

Të drejtat e publikut për përdorimin e shërbimit ndërkombëtar të telekomunikacionit

Ndryshuar 179-1998 Shtetet anëtare njohin të drejtat e publikut për korrespodencë në kuptimet e shërbimit ndërkombëtar të korrespodencës publike. Shërbimet, çmimet dhe masat e sigurisë do të jenë të njëjta për të gjithë përdoruesit në çdo kategori të korrespodencës pa ndonjë përparësi apo preferencë.

Neni 34

Bllokim i telekomunikacioneve

Ndryshuar 180-1998 1. Shtetet anëtare rezervojnë të drejtën të ndërpresin, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, transmetimin e ndonjë telegrami privat, i cili mund të shfaq rrezik në sigurinë e shtetit ose bie në kundërshtim me ligjet e tij, me interesat dhe etikën publike, duke bërë njoftimin e menjëhershëm të zyrës nga ku është origjina e telegramit për ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të tij, nëse ky njoftim nuk përbën rrezik për sigurinë e shtetit.

Ndryshuar 181-1998 2. Shtetet anëtare rezervojnë të drejtën, gjithashtu të ndërpresin në përputhje me ligjin e tyre kombëtar ndonjë shërbim tjetër privat telekomunikacioni, i cili mund të shfaqë rreziqe në sigurinë e shtetit ose bie në kundërshtim me ligjet e tyre, me interesat dhe etikën publike.

Neni 35

Pezullimi i shërbimeve

Ndryshuar 182-1998 Çdo shtet anëtar rezervon të drejtën të pezullojë shërbimin ndërkombëtar të telekomunikacionit, në përgjithësi ose për marrëdhënie të caktuara dhe/ose lloje të caktuara të korrespodencës, hyrëse, dalëse ose transit, me kusht që, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të njoftojë

menjëherë çdo shtet anëtar tjetër për ndërmarrjen e një veprimi të tillë.

Neni 36
Përgjegjësitë

Ndryshuar 183-1998 1. Shtetet anëtare nuk pranojnë përgjegjësi kundrejt përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacionit, veçanërisht kur bëhet fjalë për dëmtime.

Neni 37
Sekreti në telekomunikacione

Ndryshuar 184-1998 1. Shtetet anëtare bien në marrëveshje për të marrë të gjitha masat, në përputhje me sistemet e tyre të telekomunikacionit, për sigurimin e sekretit të korrespodencës ndërkombëtare.

Neni 38
Krijimi, operimi dhe mbrojtja e kanaleve dhe instalimeve të telekomunikacionit

Ndryshuar 186-1998 1. Shtetet anëtare bien dakord që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar krijimin e kanaleve të komunikimit, në kushte më të mira teknike, dhe instalimet e nevojshme për realizimin e një shkëmbimi të shpejtë dhe pa ndërprerje të telekomunikacioneve ndërkombëtare.

Ndryshuar 188-1998 2. Shtetet anëtare, brenda juridiksionit të tyre, do të ruajnë dhe do të sigurojnë këto kanale dhe instalime.

Ndryshuar 189-1998 4. Nëse nuk egzistojnë kushte të tjera të vendosura nga marrëveshje speciale, çdo shtet anëtar do të marrë masat e nevojshme për sigurimin e mirëmbajtjes të atyre sektorëve të qarqeve ndërkombëtare të telekomunikacioneve, që janë brenda kontrollit të tij.

Shtuar 189A- 1998 Shtetet anëtare njohin nevojën e marrjes së masave të domosdoshme për të ndaluar operimin e aparaturave dhe instalimeve elektrike të të gjitha llojeve, kur ato shkaktojnë shqetësime në operimin e instalimeve të telekomunikacionit, që ndodhen nën juridiksionin e shteteve anëtare të tjera.

Neni 39
Informimi për shkelje

Ndryshuar 190- 1998 Me qëllim që të lehtësohet zbatimi i dispozitave të nenit 6 të kësaj Kushtetute, shtetet anëtare duhet të informojnë dhe, nëse nevojitet, të ndihmojnë njëri-tjetrin në lidhje me shkeljet e dispozitave të kësaj Kushtetute, të konventës dhe të rregulloreve administrative.

Neni 42
Marrëveshje specifike

Ndryshuar 193-1998 Për agjencitë operuese të njohura nga ata dhe për agjencitë e tjera të autorizuara, shtetet anëtare rezervojnë të drejtën të hartojnë marrëveshje speciale për çështjet e telekomunikacionit që nuk i përkasin, në përgjithësi, shteteve anëtare. Megjithatë, të tilla marrëveshje nuk duhet të krijojnë konflikt me dispozitat e kësaj Kushtetute, të konventës ose rregulloreve administrative, përsa kohë kanë lidhje me interferenca të dëmshme të shkaktuara në shërbimet radio të shteteve anëtare të tjera, dhe në përgjithësi për sa kohë kanë lidhje me dëmtime teknike, shkaktuar në shërbimet e telekomunikacioni të shteteve anëtare të tjera.

Neni 43
Konferencat rajonale, marrëveshjet dhe organizatat

Ndryshuar 194-1998 Shtetet anëtare kanë të drejtën të kërkojnë organizimin e konferencave rajonale, të lidhin marrëveshje rajonale dhe të formojnë organizata rajonale, me qëllim zgjidhjen e çështjeve të telekomunikacionit, të cilat janë subjekt i trajtimit në bazë rajonale. Të tilla marrëveshje nuk duhet të bien në konflikt me këtë Kushtetutë ose me konventën.

KAPITULLI VII
KËRKESA TË VEÇANTA PËR RADIO-VALËT

Neni 44

Ndryshuar përdorimi i spektrit të radio-frekuencave dhe i orbitave satelitëve gjeostacionere dhe satelitëve të tjerë

(Ndryshuar) 195-2002 1. Shtetet anëtare do të përpiqen të kufizojnë numrin e frekuencave dhe spektrin e përdorur në minimumin e domosdoshëm që siguron në një mënyrë të kënaqshme shërbimet e duhura. Për këtë ata do të përpiqen të venë në zbatim zhvillimet më të fundit teknike sa më parë që të jetë e mundur.

Ndryshuar 196-1998 2. Në përdorimin e brezave të frekuencave për shërbimet radio, shtetet anëtare duhet gjithmonë të bazohen në faktin që radio frekuencat dhe orbitat satelitore, përfshirë këtu dhe orbitat e sateliteve gjeostacionare, janë burime të kufizuara natyrore dhe që duhen përdorur në mënyrë racionale, efikase dhe ekonomike, në përputhje me dispozitat e rregulloreve radio, në mënyrë që shtetet apo grupet e shteteve të mund të kenë akses të barabartë në këto orbita dhe frekuenca, duke marrë parasysh nevojat specifike të vendeve në zhvillim dhe pozitat e tyre të veçanta gjeografike.

Neni 45
Interferencat e dëmshme

Ndryshuar 197-1998 1. Të gjitha stacionet, pavarësisht qëllimit të tyre, duhet të instalohen dhe të operojnë në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimet radio ose në transmetimet e shteteve anëtare të tjera, të agjencive operuese të njohura ose agjencive operuese të autorizuara, të cilat kryejnë shërbime radio, dhe që operojnë në përputhje me dispozitat e rregulloreve radio.

Ndryshuar 198-1998 2. Çdo shtet anëtar merr përsipër t'u kërkojë agjencive operuese të njohura prej tyre ose agjencive operuese të autorizuara për këtë qëllim të ndjekin dispozitat e nr.197 më sipër.

Ndryshuar 199-1998 3. Në vazhdim, shtetet anëtare njohin domosdoshmërinë e marrjes së të gjitha masave të nevojshme për të ndaluar operimin e aparaturave dhe instalimeve elektrike të të gjitha llojeve që shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimet radio ose transmetimet e përmendura në nr.197 më sipër.

Neni 47
Sinjale false ose të rreme për fatkeqësi, urgjencë, shpëtim ose identifikim

Ndryshuar 201-1998 Shtetet anëtare duhet të bien dakord që të marrin masat e nevojshme për të ndaluar transmetimin ose qarkullimin e sinjaleve false apo të rreme për fatkeqësi, urgjencë, shpëtim ose indentifikim, dhe të bashkëpunojnë për lokalizimin dhe identifikimin e stacioneve, që ndodhen nën juridiksionin e tyre, të cilat transmetojnë sinjale të tilla.

Neni 48
Instalimet për shërbimet kombëtare të mbrojtjes

Ndryshuar 202-1998 1. Shtetet anëtare ruajnë pavarësinë e tyre të plotë lidhur me instalimet radio ushtarake.

KAPITULLI VIII
MARRËDHËNIET ME KOMBET E BASHKUARA, ORGANIZATAT
E TJERA NDËRKOMBËTARE DHE SHTETET JOANËTARE

Neni 50
Marrëdhëniet me organizatat e tjera ndërkombëtare

Ndryshuar 206-2002 Në mbështetje të koordinimeve ndërkombëtare për çështje që i përkasin telekomunikacionit, Unioni duhet të kooperojë me organizatat ndërkombëtare me të cilat ka lidhje interesash dhe veprimtarie.

Neni 51
Marrëdhëniet me shtetet joanëtare

Ndryshuar 207-1998 Çdo shtet anëtar rezervon, për vete dhe për agjencitë e njohura operuese, të drejtën për të përcaktuar kushtet në të cilat ajo lejon shkëmbime të ndërsjella telekomunikacioni me një shtet i cili nuk është shtet, anëtar në Union. Në qoftë se origjinimi i telekomunikacionit nga territori i një shteti të tillë është pranuar nga një shtet anëtar, atëherë do të respektohen dispozitat detyruese të kësaj Kushtetutë, të konventës dhe të rregulloreve administrative, si dhe pagesat që kërkohen në këto raste.

KAPITULLI IX
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 52
Ratifikimi, pranimi ose miratimi

Ndryshuar 208-1998 1. Kjo Kushtetutë dhe konventë duhet njëkohësisht të ratifikohen, pranohen ose aprovohen nga pala nënshkruese e shtetit anëtar, në përputhje me rregullat e saj institucionale, në një instrument të vetëm. Ky instrument do të depozitohet, në një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur, pranë Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë shtetet anëtarë për çdo depozitim të një instrumenti të tillë.

Ndryshuar 209 2*-1998* 1) Gjatë periudhës dyvjeçare që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe konventës, pala nënshkruese e shtetit anëtar, edhe sikur të mos ketë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi apo miratimi, në përputhje me nr.208 më sipër, do të gëzojë të drejtat e shtetit anëtar, sipas nr.25 deri 28 të kësaj Kushtetute.

Ndryshuar 210-1998 2) Në fund të periudhës dyvjeçare që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe konventës, pala nënshkruese e shtetit anëtar, i cili nuk ka depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit apo miratimit, në përputhje me nr.208 më sipër, nuk do t'i jepet më e drejta të votojë, deri sa të depozitojë atë, në konferencat e Unionit, në sesionet e Këshillit, në mbledhjet e çdo Sektori të Unionit, ose gjatë konsultimeve nga korrespondencat, drejtuar në përputhje me dispozitat e kësaj Kushtetute dhe të konventës. Të drejtat e tij, të tjera nga të drejtat e votës, nuk do të preken.

Neni 53
Hyrja në fuqi

Ndryshuar 212-1998 1. Një shtet anëtar i cili nuk është palë nënshkruese e kësaj Kushtetute dhe e konventës ose subjekt i kërkesave të nenit 2 të kësaj Kushtetute, ndonjë shtet tjetër referuar në këtë nen, mund sjell në fuqi, në çdo kohë, këtë Kushtetutë dhe konventën. Hyrja në fuqi do të bëhet në formën e një instrumenti të vetëm që mbulon se bashku Kushtetutën dhe konventën.

Ndryshuar 213-1998 2. Instrumenti i pranimit do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do të njoftojë shtetet anëtarë për çdo depozitim të ndonjë instrumenti të tillë dhe do t'i drejtojë secilit prej tyre një kopje të certifikuar.

Neni 54
Rregulloret administrative

Shtuar 216A- 1998 Rregulloret administrative, referuar në nr.216, do të mbeten në fuqi edhe pas rishikimeve të miratuara, që janë bërë në bazë të kërkesave sipas nr.89 dhe 146 të kësaj Kushtetute. Çdo rishikim i rregulloreve administrative, i pjesshëm apo i plotë, do të hyjë në fuqi në datën apo datat e specifikuara për këtë nga shtetet anëtare, të cilët para datës apo datave të tilla, kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për miratimin nga ana e tyre të këtyre rishikimive.

Hequr 217- 1998

Shtuar 217A- 1998 Një shtet anëtar do të njoftojë miratimin e tij të rishikimeve të pjesshme apo të plota të rregulloreve administrative nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo hyrje në forcë ose nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm për këtë miratim.

Shtuar 217B-1998 Çdo shtet anëtar mund, gjithashtu të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që ratifikimi, pranimi, miratimi ose hyrja në fuqi e amendimeve të kësaj Kushtetute ose konventës, në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës ose nenin 42 të konventës do të kërkojë miratimin e ndonjë rishikimi të rregulloreve administrative, të pjesshme apo të plotë të aprovuar nga një konferencë kompetente para nënshkrimit të amendimeve të mësipërme të kësaj Kushtetute ose të konventës.

Shtuar 217C- 1998 Njoftimet, referuar nr.217B më sipër, do të jepen në kohën e depozitimit nga shteti anëtar të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi të amendimeve të kësaj Kushtetute ose të konventës.

Shtuar 217D- 1998 Çdo rishikim i rregulloreve administrative do të zbatohet përkohësisht, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, nga çdo shtet anëtar që ka nënshkruar rishikimin dhe nuk ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për miratimin në përputhje me nr.217A dhe 217B më sipër. Të tilla zbatime të përkohshme kanë efekt vetëm nëse shteti anëtar që ka rezerva nuk e kundërshton atë në kohën e nënshkrimit të rishikimit.

Ndryshuar 218- 1998 4. Të tilla zbatime të përkohshme nga një shtet anëtar do të vazhdojnë deri sa të informojë Sekretarin e Përgjithshëm për vendimin e tij lidhur me miratimin e një rishikimi të tillë

Hequr 219 deri 221-1998

Shtuar 221A-1998 Në qoftë se një shtet anëtar nuk njofton Sekretarin e Përgjithshëm për vendimin e tij lidhur me miratimin e rishikimit, sipas nr.218 më sipër, brenda tridhjetë e gjashtë muajve nga data ose datat e hyrjes në fuqi të rishikimit, ky shtet anëtar do të konsiderohet se e ka miratuar këtë rishikim.

Shtuar 221B-1998 Çdo zbatim i përkohshëm, në kuptimin e nr.217D ose çdo miratim në kuptimin e nr.221A, do të jetë subjekt rezervimi i kërkuar nga shteti anëtar përkatës në kohën e firmosjes së rishikimit. Çdo miratim i rishikimit, në kuptimin e nr.216A, 217A, 217B dhe 218 më sipër, do jetë subjekt rezervimi i kërkuar nga shteti anëtar përkatës në kohën e firmosjes së rregulloreve administrative ose rishikimit të tyre, me kusht që të sigurojë rezervimin kur të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për miratimin e rishikimit.

Hequr 222-1998

Ndryshuar 223-1998 7. Sekretari i Përgjithshëm do të informojë menjëherë shtetet anëtare për njoftimet e marra në zbatim të këtij artikulli.

Neni 55

Dispozitat për amendimin e kësaj Kushtetute

Ndryshuar 224-2002 1. Çdo shtet anëtar mund të propozojë ndonjë ndryshim në këtë Kushtetutë. Çdo propozim i tillë, me qëllim që të sigurojë transmetimin dhe komentimin e saj nga të gjitha shtetet anëtare, duhet të arrijë pranë Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë se tetë muaj para ditës së fiksuar për hapjen e konferencës së të plotfuqishmëve. Sekretariati i Përgjithshëm, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtë muaj para datës më të vonë, do të publikojë çdo propozim të tillë me qëllim informimin e të gjitha shteteve anëtare.

Ndryshuar 225 (1998) 2. Megjithatë, çdo shtet anëtar ose nga delegatët e tij në konferencat e të plotfuqishmëve mund të kërkojnë, në çdo kohë, propozime për modifikimin e ndonjë amendimi, të paraqitur në përputhje me nr.224 më sipër.

Ndryshuar 228- 2002 5. Nëse nuk specifikohet ndryshe në paragrafët e mësipërm të këtij neni, të cilët do të kenë përparësi, do të aplikohen rregullat e përgjithshme të konferencave, asambleve dhe mbledhjeve të Unionit.

Ndryshuar 229-1998 6. Çdo amendim i kësaj Kushtetute aprovuar nga një konferencë e të plotfuqishmëve, si një e tërë ose në formën e një instrumenti të vetëm të amenduar, do të hyjë në fuqi në datën e fiksuar në konferencë ndërmjet shteteve anëtare që kanë depozituar, më parë se kjo datë, instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe instrumentin e amendimit. Përjashtohet ratifikimi, pranimi ose miratimi dhe ose hyrja në forcë vetëm e një pjese të një instrumenti amendues të tillë.

Ndryshuar 230-1998 7. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet anëtarë për depozitimin e një instrumenti të tillë ratifikimi, pranimi, miratimi ose hyrje në fuqi.

Neni 56

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Ndryshuar 233- 1998 1. Shtetet anëtare mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre për çështje që lidhen me interpretimin ose zbatimin e kësaj Kushtetute, të Konventës ose të rregulloreve administrative nëpërmjet negocimit, përmes kanaleve diplomatike duke zbatuar procedurat që përmbajnë traktatet dypalëshe apo shumëpalëshe të krijuara prej tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose nëpërmjet metodave të përbashkëta reciproke të aprovuara nga ata.

Ndryshuar 234- 1998 2. Në qoftë se asnjë nga këto metoda nuk është aprovuar, çdo shtet anëtar

palë në mosmarrëveshjeje mund të shfrytëzojë burimet e arbitrimit në përputhje me procedurat e përcaktuara në konventë.

Ndryshuar 235-1998 3. Protokolli opsional mbi zgjidhjen e detyrueshme të mosmarrëveshjeve që lidhet me këtë Kushtetute, konventën dhe rregulloret administrative do të jetë i aplikueshëm ndërmjet shteteve anëtare, palë të këtij protokolli.

Neni 57

Deklarim pavlefshmërie i kësaj Kushtetute dhe i konventës

Ndryshuar 236-1998 1. Çdo shtet anëtar i cili ka ratifikuar, pranuar, aprovuar ose sjellë në fuqi këtë Kushtetute dhe konventën do të ketë të drejtën t'i deklarojë të pavlefshme ato. Në këtë rast, kjo Kushtetutë dhe konventa do të deklarohen njëkohësisht si të pavlefshme në një instrument të vetëm, me një njoftim adresuar Sekretarit të Përgjithshëm. Me marrjen e këtij njoftimi, Sekretari i Përgjithshëm do të këshillohet me shtetet anëtare të tjera.

Neni 58

Hyrja në fuqi dhe çështjet e lidhura me të

Ndryshuar 238- 2002 1. Kjo Kushtetutë dhe konventë, aprovuar nga konferenca plotësuese e të plotfuqishmëve (Gjenevë, 1992) do hyjë në fuqi më 1 korrik 1994 ndërmjet shteteve anëtare që kanë depozituar, para kësaj date, instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi.

Pjesa II-Data e hyrjes në fuqi

Ndryshimet që përmbajnë instrumentet prezent, të marrë si një e tërë dhe në formën e një instrumenti të vetëm, do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2004 ndërmjet shteteve anëtare që janë, në këtë kohë, palë në Kushtetutën dhe konventën e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992), dhe që kanë depozituar para kësaj datë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi të instrumentit aktual të ndryshuar.

INSTRUMENTI QË AMENDON KONVENTËN E BASHKIMIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT (GJENEVË 1992)

Miratuar nga Konferenca e të Plotfuqishmëve në Kyoto, 1994, nga Konferenca e të Plotfuqishmëve në Minneapolis, 1998 dhe Konferenca e të Plotfuqishmëve në Marrakesh 2002

HYRJE

Për arsye dhe në zbatim të dispozitave përkatëse të konventës së Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë 1992), në veçanti atyre të nenit 42, te Konferenca e të Plotfuqishmëve (Kyoto, 1994), Konferenca e Plotfuqishmëve (Minneapolis, 1998) dhe Konferenca e Plotfuqishmëve (Marrakesh, 2002) kanë aprovuar amendimet e mëposhtme të konventës.